



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 673 Akti

Nr. 608 Vendim
Tiranë, më 22.12.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Valbona Sanxhaktari	Kryesuese
Firdes Shuli	Relatore
Olsi Komici	Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Ertugena Sokoli, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, përkatësisht, z. Theo Jacobs në datën 21.12.2022 dhe z. Steven Kesler në datën 22.12.2022, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Elion Mustafaj**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisionere Firdes Shuli, mori në shqyrtim çdo provë dhe dokument të vënë në dispozicion nga organet kompetente ligjore, shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, përfundoi procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Elion Mustafaj, i cili në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Z. Elion Mustafaj është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, aktualisht prokuror Drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016).

2. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, është zhvilluar shorti në datën 15.12.2020, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit Elion Mustafaj do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Valbona Sanxhaktari, Firdes Shuli dhe Olsi Komici. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Firdes Shuli.

3. Për këtë subjekt rivlerësimi u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016; dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP), sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.

4. Me vendimin nr. 1, datë 22.12.2020, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Elion Mustafaj, duke u bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit, si dhe të caktoj kryesuesen e trupit gjykues, komisioneren Valbona Sanxhaktari. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit. Në datën 17.10.2022, subjekti deklaroi përmes postës elektronike se nuk ka konflikt interesi me ndonjë nga anëtarët e trupit gjykues.

5. Me vendimin nr. 2, datë 15.12.2022, trupi gjykues vendosi mbylljen e hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit Elion Mustafaj dhe vendimmarrja në përfundim të procesit të rivlerësimit të bazohet në të tria kriteret: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016.

6. Në datën 15.12.2022, përmes postës elektronike, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit administrativ për të tria kriteret; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të dhënë sqarime mbi konstatimet e Komisionit, jo më vonë se data 20.12.2022; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative.

7. Në datën 19.12.2022, subjekti i rivlerësimit dërgoi përmes postës zyrtare parashtrimet e tij dhe dokumentacionin shoqërues mbi rezultatet e hetimit administrativ.

8. Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, me vendimin nr. 3, datë 19.12.2022, trupi gjykues vendosi kalimin e çështjes në seancë dëgjimore.

9. Në datën 21.12.2022 u zhvillua seanca dëgjimore, në të cilën subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin e tij në detyrë.

II. PARIME TË PËRGJITHSHME TË PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

10. Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së

Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

11. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera, që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

12. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, Inspektorati i Lartë i Deklarimit të Kontrollit dhe Pasurive dhe Konfliktit të Interesit është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit. Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin në lidhje me kontrollin e figurës. Sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016, parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

13. Referuar vendimit nr. 2/201721 të Gjykatës Kushtetuese, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse, bazuar në nenet 45,46, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, duke marrë në analizë: (i) raportin e dorëzuar nga ILDKPKI-ja dhe dokumentet shkresore të vëna në dispozicion nga ky institucion vlerësimi; (ii) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar nga DSIK-ja dhe dokumentet shkresore të vëna në dispozicion nga ky institucion vlerësimi; (iii) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP) dhe dokumentet shkresore të paraqitura prej tyre; (iv) provat shkresore/dokumentet e vëna në dispozicion nga institucionet apo subjektet publike a private; (v) denoncimet e publikut, sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016 dhe çdo informacion i marrë në rrugë ligjore; (vi) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit; (vii) sugjerime/opinione të vëzhguesit të ONM-së.

III. FAKTET DHE PROVAT MBI TË CILAT ËSHTË MARRË VENDIMI

VLERËSIMI I PASURISË

14. Në zbatim të nenit 31/1 të ligjit nr. 84/2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit Elion Mustafaj ka dorëzuar pranë ILDKPKI-së deklaratën e pasurisë në datën 24.1.2017, pra, në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi. Gjithashtu, në referencë të nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, vërehet se subjekti i rivlerësimit është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2004, me nr. indeksi *** dhe ka dorëzuar sipas ligjit deklaratën përpara fillimit të detyrës (në vijim DPF) në vitin 2004 në funksionin e kancelarit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës, DPF/2012 e në vijim deklaratat periodike vjetore (në vijim DPV) në funksionin e prokurorit.

15. ILDKPKI-ja ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë, ku, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për subjektin Elion Mustafaj, ka konstatuar se: (i) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin; (ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

16. Në përmbushje të funksioneve të tij kushtetuese, sipas pikës 1 të nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka kryer një proces të plotë hetimi administrativ për pasurinë e subjektit të rivlerësimit

Elion Mustafaj, si dhe të personave të lidhur me të, sipas dispozitave ligjore të kreut VII të ligjit nr. 84/2016.

17. Hetimi administrativ, në lidhje me rivlerësimin e pasurisë, konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin ose jo të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin ose jo të fshehjes së pasurive; (iv) evidentimin e deklarimeve të rreme; si dhe (v) nëse subjekti ndodhet në situatën e konfliktit të interesit, me qëllim verifikimin e deklarimeve të pamjaftueshme në lidhje me kriterin pasuror, sipas parashikimit të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet nenit 33 të tij.

Pasuri të deklaruara në deklaratën *Vetting* nga subjekti i rivlerësimit

18. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar: “*Apartament banimi, në pronësi në pjesën 50%, me sipërfaqe 88.6 m², me adresë në ***, Tiranë, blerë në vitin 2007, me shumën 42.528 euro, në bashkëpronësi me babain E. M. Burimi i krijimit është: (a) kredi në shumën 22.000 euro; dhe (b) pjesa tjetër nga të ardhurat familjare të prindërve dhe të mia ndër vite*”. ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika në lidhje me këtë pasuri.

Hetimi i Komisionit në lidhje me këtë pasuri

Në lidhje me origjinën, mënyrën e përfitimit të pasurisë dhe deklaratimet e subjektit

19. Nga dokumentet e administruara gjatë hetimit administrativ¹ rezultoi se në rend kronologjik janë kryer veprimet si vijojnë:

- Me kontratë sipërmarrjeje nr. ***, datë 29.9.2005, shtetasi E. M. (babai i subjektit), në cilësinë e porositësit, ka porositur nga shoqëria “****” sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit, një apartament me sip. ndërtimore 95.8 m², 2+1+ambiente ndihmëse, kati ***, ap nr. ***, ndodhur në ***, Tiranë, me çmim 38.320 euro. Nga planimetria e apartamentit nr. ***, bashkëngjitur kësaj kontrate, vërehet se në sipërfaqen totale është përfshirë edhe sipërfaqja e përbashkët prej 7.2 m².

- Në datën 28.12.2006 është regjistruar në pronësi të shoqërisë “****” sh.p.k. pasuria me nr. ***, z.k. ***, apartament me sip. 88.6 m², në ***, Tiranë, konfirmuar nga certifikata për vërtetim pronësie, lëshuar në datën 3.5.2007 dhe kartela e pronësisë.

- Me kontratë shitblerjeje me rezervë nr. ***, datë 4.6.2007, blerësit E. M. dhe Elion Mustafaj kanë blerë nga shoqëria “****” sh.p.k. pasurinë nr. ***, apartament me sip. 88.6 m², me çmim 42.528 euro. Siç vërehet, në ndryshim nga kontrata e sipërmarrjes, në këtë kontratë, në cilësinë e blerësit, përveç babait të tij, shfaqet edhe vetë subjekti. Po kështu, vërehet se sipërfaqja e apartamentit është më e vogël sesa sipërfaqja e parashikuar në kontratën e sipërmarrjes dhe çmimi është i ndryshëm gjithashtu. Gjatë hetimit administrativ, subjekti ka dhënë sqarime bindëse në lidhje me: (i) përfshirjen e tij në kontratën e shitjes duke deklaruar se ai është ftuar nga babai i tij për t’u bërë pjesë e kontratës së shitjes, sepse për vetë moshën e prindërve të tij, në pension pleqërie, ata nuk mund të merrnin kredi dhe, në këtë mënyrë, rrezikohej blerja e apartamentit; (ii) mospërputhjet e sipërfaqeve në të dyja kontratat, duke sqaruar se në kontratën e shitjes me rezervë nuk është përfshirë sipërfaqja e përbashkët prej 7.2 m², e cila ishte e përfshirë në sipërfaqen totale prej 95.8 m² në kontratën e sipërmarrjes. Sqarimet në lidhje me çmimin e apartamentit janë trajtuar në vijim në paragrafin 22 të vendimit.

- Në datën 4.9.2007, pasuria me nr. *** është regjistruar në bashkëpronësi të shtetasve E. M. dhe Elion Mustafaj, me ½ pjesë takuese/secili, sipas certifikatës për vërtetim pronësie, lëshuar në datën

¹Shihni aktet në aneksin 4/1 në dosjen e ILDKPKI-së dhe përgjigjet e pyetësorit nr. 2 në dokumentacionin bashkëngjitur, në dosjen e Komisionit.

10.9.2007. Në kartelën e pasurisë vërehet se prona është hipotekuar në favor të “***”, për shumën 25.000 euro, sipas kontratës së hipotekës nr. ***, datë 13.9.2007.

- Pasuria është deklaruar në DIPFD/2012, në të njëjtën mënyrë si në deklaratën *Vetting*.

- Aktualisht, pasuria nr. ***, vijon të jetë e regjistruar në bashkëpronësi të subjektit Elion Mustafaj dhe babait të tij E. M.². FSHU-ja³ ka konfirmuar kontratën e furnizimit me energji në emër të shtetasit E. M. në instancën ***, Tiranë, e cila, referuar detajeve të klientit, është lidhur në datën 15.5.2007 dhe pagesat nisin në muajin qershor të vitit 2007.

Në përfundim të hetimit administrativ nuk u konstatuan problematika në lidhje me origjinën dhe mënyrën e krijimit të pasurisë.

Në lidhje me çmimin e blerjes së apartamentit dhe mënyrën e pagesës

20. Nga verifikimi i akteve noteriale të administruara, u konstatua se:

- Kontrata e sipërmarrjes e datës 29.9.2005 parashikon që çmimi i apartamentit është në vlerën 38.320 euro dhe do të paguhet si vijon: (a) kësti i parë me vlerë 20.000 euro u pagua sot me lidhjen e kontratës; (b) kësti i dytë me vlerë 18.320 euro do të paguhet tre muaj nga momenti i marrjes së certifikatës së pronësisë, nëpërmjet kredisë që do të sigurojë sipërmarrësi. Pagimi i shumës 20.000 euro nga babai i subjektit E. M. vërtetohet me mandatarëtimin datë 29.9.2005⁴.

- Kontrata e shitjes me rezervë e datës 4.6.2007 parashikon se çmimi i apartamentit është 42.528 euro, shumë e cila do të paguhet si vijon: (i) kësti i parë i pagesës së çmimit të shitjes së apartamentit do të realizohet nga ana e blerësit në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate dhe do të jetë në shumën 24.208 euro; (ii) kësti i dytë i pagesës, që nënkupton edhe likuidimin total nga ana e blerësit të diferencës së mbetur prej 18.320 euro, do të bëhet në momentin e çeljes nga ana e bankës të kredisë.

- Në deklaratën noteriale nr. ***, datë 23.1.2017⁵, prindërit e subjektit, deklaruesit E. M. dhe F.M., kanë deklaruar se çmimi prej 42.528 euro është paguar me dy këste. Shuma prej 20.528 euro është paguar para lidhjes së kontratës së shitjes me rezervë të pasurisë, kurse shuma prej 22.000 euro është marrë hua nga “Alpha Bank”, sipas kontratës së datës 13.9.2007.

21. Nga përmbajtja e akteve të mësipërme, vërehet se: së pari, në kontratën e shitjes me rezervë të vitit 2007, çmimi i blerjes së apartamentit (42.528 euro) është më i lartë se çmimi i parashikuar në kontratën e sipërmarrjes të vitit 2005 (38.320 euro); së dyti, mënyra e likuidimit të këstit të parë të çmimit të shitjes në kontratën e shitjes nuk përputhet me parashikimet e kontratës së sipërmarrjes dhe parashikimet e deklaratës noteriale nr. ***, datë 23.1.2017.

22. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2 subjekti ka informuar se rritja e çmimit në kontratën e shitjes ka ardhur për shkak të kryerjes së punimeve shtesë në apartament. Konkretisht, ai ka sqaruar se babai i tij në marrëveshje me shoqërinë “***” sh.p.k. dhe në vijim të kontratës së sipërmarrjes, nenit 3 të saj⁶, kanë rënë dakord të kryeshin disa ndryshime (punime shtesë), të cilat kanë shtuar vlerën e kostos së apartamentit me 4.208 euro më tepër se vlera totale prej 38.320 euro, e

²Shihni shkresën kthim-përgjigjeje nga ZVRPP Tiranë, bashkëngjitur shkresë kthim-përgjigjeje nr. ***, datë 15.2.2018, nga ZQRPP Tiranë në aneksin 28 në dosjen e ILDKPKI-së dhe kartelë elektronike e pasurisë së paluajtshme me datë printimi 24.10.2022, bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2 në dosjen e Komisionit.

³Shihni shkresë kthim-përgjigjeje nr. *** prot., datë 3.3.2021, dhe shkresë kthim-përgjigjeje nr. *** prot., datë 10.11.2022, nga FSHU-ja në dosjen e Komisionit.

⁴Në parashtrimet e tij, me kërkesë të Komisionit, subjekti ka paraqitur kopje të njësuar me origjinalin të mandatarëtimin datë 29.9.2005.

⁵Shihni dokumentin në aneksin nr. 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁶Në këtë nen të kontratës së sipërmarrjes parashikohet se: “*Shoqëria merr përsipër të njoftojë porositësin para se të vendoset muri i tullës për ndryshimet në konstrukt. Në këtë rast këto ndryshime do të jenë në koston e ndërtimit. Në rast se porositësi kërkon të bëjë ndryshime, pasi është vendosur muri i tullës, atëherë ndryshimet do të bëhen nga shoqëria ndërtimore, por janë në koston e porositësit*”.

parashikuar në kontratën e sipërmarrjes. Subjekti ka informuar se nuk ka ndonjë akt formal mbi vlerën e punimeve shtesë, pasi palët nuk kanë pasur mosmarrëveshje për natyrën dhe vlerën e punimeve, të cilat i kanë dakordësuar mes tyre. Më tej, subjekti ka sqaruar se në kontratën e shitjes me rezervë të vitit 2007 është pasqyruar çmimi total i shitjes së apartamentit në vlerën totale prej 42.528 euro, pra është shtuar edhe vlera e punimeve shtesë prej 4.208 euro. Këto deklarime të subjektit janë konfirmuar edhe nga shtetasi G. I., administrator i shoqërisë “****” sh.p.k. në vitin 2007⁷. Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni konsideroi si çmim të blerjes së pasurisë vlerën 42.528 euro.

23. Po në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, në lidhje me likuidimin e çmimit të shitjes, subjekti ka informuar se në momentin e lidhjes së kontratës së shitjes me rezervë të vitit 2007 nuk i është kushtuar vëmendje formulimit të bërë mbi mënyrën dhe kohën e kryerjes së pagesës për këstin e parë. Kjo, sipas tij, mund të ketë ardhur, ndër të tjera, edhe për faktin se me pagesat është marrë babai i tij, por, për shkak të kohës së gjatë nuk mund të konfirmojë rrethana konkrete. Në përfundim të deklarimeve, subjekti ka rikonfirmuar se:

- Kësti i parë me vlerë 24.208 euro, i është paguar *cash* shitësit në këtë mënyrë: (i) vlera 20.000 euro është paguar në datën e kontratës së sipërmarrjes, sipas mandatarkëtimit me datë 29.9.2005; (ii) vlera 4.208 euro është paguar në momentin që është rënë dakord për nënshkrimin e kontratës së shitjes me rezervë datë 4.6.2007, si shkak i punimeve shtesë të kryera, por nuk disponon mandatpagesë.

- Kësti i dytë me vlerë 18.320 euro është paguar nëpërmjet kredisë së disbursuar në datën 28.9.2007 nga “Alpha Bank”, likuiduar në këtë mënyrë: (i) shuma prej 17.900 euro ka kaluar po në datën 28.9.2007 për llogari të shtetasit G. I., sipas *statement*-it bankar me përshkrim “kaluar G. I. për likuidim kësti kredie”; (ii) vlera 420 euro duhet të jetë paguar *cash*, por nuk disponohet ndonjë dokument.

24. Në mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti ka paraqitur dokumentet shkresore të poshtëshënuara:

- deklaratë noteriale nr. ***, datë 25.10.2022, të shtetasit G. I., administrator i shoqërisë, në të cilën ai konfirmon deklaratimet e subjektit;
- mandatarkëtimi datë 19.9.2005 për derdhjen e shumës 20.000 euro;
- kontratë sipërmarrjeje nr. ***, datë 29.9.200 dhe planimetri të apartamentit.
- vërtetim nga “Alpha Bank”, lëshuar në datën 24.10.2022, sipas të cilit kredia e marrë nga shtetasit E. M. dhe F. M. është disbursuar në datën 28.9.2007, në vlerën 22.000 euro, nga e cila vlera 17.900 euro ka kaluar në llogari të z. G. I. për likuidim kësti për blerje apartamenti, ndërsa vlera 3.878 euro ka kaluar në llogari të shtetasit N. J. për likuidim detyrimi;
- *statement* bankar, ku evidentohet një veprim bankar i datës 28.10.2007, me përshkrimin “kalim nga Elion Mustafaj për G. I. – likuidim kësti për blerje apartamenti” në shumën 17.900;
- deklaratë noteriale nr. *** regj., nr. *** kol., datë 2.7.2007, e shtetasit N. J., në të cilën deklaroi se i ka dhënë hua z. Elion Mustafaj shumën 4.000 euro, që ai e ka përdorur për blerjen e apartamentit në vitin 2007.

25. Komisioni ka analizuar çmimin e blerjes së apartamentit me sip. 95.8 m² (përfshirë edhe ambientet e përbashkëta sipas parashikimit në kontratën e sipërmarrjes) me çmimin referuar EKB-së, sipas udhëzimit të vitit 2005⁸, i cili përcakton të dhënat në tregun e lirë të apartamenteve në qytetin e Tiranës për vitin 2005 për çmimin e shitjes 77.452 lekë/m². Duke llogaritur sipërfaqen 95.8 m² x 77.452 lekë = 7.419.902 lekë ose 60.109 euro⁹, vërehet se ka një diferencë prej 17.581

⁷Shihni deklaratën noteriale nr. ***, datë 25.10.2022 në dokumentet bashkëlidhur pyetësorit nr. 2.

⁸Udhëzimi nr. 5, datë 23.11.2005, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB për vitin 2005”.

⁹Referuar kursit zyrtar të Bankës së Shqipërisë ku më 29.9.2005, 1 euro = 123.44 lekë.

euro me çmimin e blerjes së apartamentit në shumën 42.528 euro, përcaktuar në kontratën e shitjes më rezervë. Pra, siç vërehet, subjekti e ka blerë pasurinë me çmim më të ulët sesa çmimi i tregut.

26. Edhe pse pasuria është porositur në vitin 2005 prej babait të subjektit dhe është blerë në vitin 2007, kur subjekti nuk ka ushtruar detyrën e prokurorit, Komisioni kreu verifikime mbi gjendje konflikti të mundshëm interesi të subjektit me shoqërinë “****” sh.p.k. dhe shtetasin G. K. I., ku pas kërkesës së Komisionit, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë¹⁰ informoi se për periudhën 2007 – 2013, që subjekti ka ushtruar detyrën e oficerit të policisë gjyqësore në këtë prokurori, nuk rezultoi të kishte procedime penale të hetuara prej tij.

Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie

27. Në DPPFD/2012 dhe në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar si burim krijimi të kësaj pasurie: (a) kredi në shumën 22.000 euro; (b) pjesa tjetër nga të ardhurat familjare të prindërve dhe të tij ndër vite. Komisioni ka analizuar secilin prej burimeve për të evidentuar mundësinë financiare për blerjen e pasurisë.

28. Analizë e burimit “kredi në shumën 22.000 euro”, për të cilën nga dokumentet e administruara¹¹ u konstatua se:

- Sipas kontratës nr. ***, datë 13.9.2007, me kredidhënës “Alpha Bank” dhe kredimarrës shtetasit Elion Mustafaj, E. M. dhe F. M., është akorduar kredi në shumën 25.500 euro me afat të pacaktuar, për ta përdorur me qëllim sipas nevojave të tij.

- Sipas kontratës së huas nr. ***, datë 13.9.2007, “shtesë e kontratës për kufi kredie shumëqëllimore nr. ***, datë 13.9.2007, me nr. ***, datë 13.9.2007”, banka çel në favor të kredimarrësit një kufi kredie në shumën 25.500 euro, që mund të përdoret tërësisht ose pjesërisht për nevoja të kredimarrësit për kredi, hua, avanca, garanci, dorëzani etj. Nga ky kufi deri më sot është përdorur vlera 22.000 euro për blerje apartamenti në ***, Tiranë. Projekti ka kosto të përgjithshme 42.528 euro dhe kontributi i kredimarrësit në financimet e projektit është 20.528 euro ose 48% e koston së përgjithshme, ndërsa pjesa tjetër prej 22.000 euro ose 52% e tij është kërkuar të financohet nga banka. Huaja jepet me afat 20-vjeçar, me normë interesi të pandryshuar prej 5.7% në pesë vitet e para.

- Me qëllim marrjen e kësaj kredie është vendosur si hipotekë apartamenti objekt verifikimi në ***, Tiranë, me nr. pasurie ***, sipas kontratës së hipotekës nr. ***, datë 13.9.2007, me palë “Alpha Bank” dhe në cilësinë e përfituesit të hipotekës shtetasit E.M., F. dhe Elion Mustafaj.

- Me dokumentin “kërkesë/autorizim për tërheqje”, shtetasit Elion Mustafaj, E. M. dhe F. M. kanë njoftuar bankën se do të tërheqin shumën 22.000 euro, e cila do të aplikohet për blerje të apartamentit në ***, Tiranë. Shuma prej 22.000 euro është disbursuar në datën 28.9.2007, konfirmuar nga “Alpha Bank” sipas vërtetimit të lëshuar në datën 24.10.2022.

- Nga verifikimi i deklarimeve të subjektit konstatohet se subjekti ka deklaruar në DPPFD/2012: “*Kredi për apartament banimi në ‘Alpha Bank’, marrë në vitin 2007, në shumën 22.000 euro, me këst mujor 154.73 euro*”. Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer deri në ditën e fillimit të punës është 18.849 euro. Kjo kredi dhe gjendja e saj është deklaruar nga subjekti në DPV-të në vijim 2012 – 2017.

- Nga lëvizjet e llogarisë së kredisë triemërore në “Alpha Bank” është evidentuar se disa këste janë derdhur prej subjektit dhe bashkëshortes së tij dhe disa të tjera nga prindërit e tyre. Në përfundim të hetimit administrativ, të gjitha pagesat e kësteve të kredisë janë përfshirë në analizën financiare të subjektit. Në prapësime, subjekti ka pretenduar se duhet t’i ngarkohen si shpenzime vetëm

¹⁰Shihni shkresën kthim-përgjigjeje nr. *** prot., datë 6.12.2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në dosjen e Komisionit.

¹¹Shihni aktet në aneksin nr. 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së.

shumat e kësteve të paguara prej tij dhe bashkëshortes, dhe jo ato të paguara nga prindërit. Komisioni ka vlerësuar të drejtë pretendimin e subjektit dhe e ka marrë në konsideratë atë duke e pasqyruar në analizën financiare të rishikuar. Megjithatë, pavarësisht masës së përfshirjes së shpenzimeve të kredisë, subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për shlyerjen e të gjitha kësteve të saj, sikurse tregohet në tabelën përfundimtare të analizës financiare të dërguar subjektit me rezultatet e hetimit administrativ.

29. Analizë e burimit “të ardhurat familjare të prindërve dhe të subjektit ndër vite”

- Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar se shuma prej 20.528 euro ka si burim: kursimet e prindërve F. dhe E. M. nga të ardhurat ndër vite të pagës dhe shfrytëzimit të ekonomisë ndihmëse (bujqësi, blegtori, vreshtari, pemëtari etj.), ndërsa shuma 1.000 euro nga kursimet e tij prej pagës. Nga dokumentet e paraqitura¹² konstatohet se:

i) të ardhurat nga paga ndër vite të prindërve të subjektit deri në datën 29.9.2005, kur është kësti prej 20.000 euro sipas kontratës së sipërmarrjes, kanë qenë në shumën 4.467.732 lekë;

ii) në lidhje me ekonominë ndihmëse nga bujqësia, blegtoria, vreshtaria etj. konstatohet se me AMTP-në nr. ***, datë 5.6.1992, familjes së shtetasit E. M. nga fshati N***, K**, i është dhënë gjithsej 9.689 m² tokë. Ai rezulton, gjithashtu, pronar i sip. 300 m² truall, nga ku 135 m² ndërtesë banimi. Sipas vërtetimit datë 21.10.2016, të lëshuar nga Njësia Administrative K***, vërtetohet se z. E. M., që prej vitit 1991 me marrjen në pronësi të tokës bujqësore, ka realizuar të ardhura nga shitja e produkteve bujqësore, pemëtaria, vreshtaria e blegtoria dhe ka shlyer të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore. Siç vërehet, është provuar që familja e subjektit ka disponuar tokë bujqësore në fshat, por nuk janë vërtetuar të ardhura konkrete. Në këto kushte nuk janë marrë në konsideratë të ardhura nga bujqësia/blegtoria, por janë reduktuar shpenzimet e jetesës në këtë mënyrë: janë zbritur nga niveli standard i shpenzimeve jetike vlera e grupit “ushqime dhe pije joalkoolike” që zë 47.6% të shpenzimeve totale, për shkak të ekonomisë bujqësore nga disponimi i tokës bujqësore nga viti 1991.

30. Në lidhje me shumën 4.208 euro, shtesë e çmimit të shitjes mbi atë të përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes datë 4.6.2007, për shkak të punimeve shtesë të kryera në apartament, qysh në pyetësorin standard nr. 1 dhe në vijim gjatë hetimit, subjekti ka deklaruar si burim një hua në shumën 4.000 euro nga vjehri N. J., ndërsa pjesa tjetër prej 208 euro ka qenë nga kursimet e prindërve. Sipas subjektit, kjo shumë i është kthyer përsëri atij në muajin shtator të vitit 2007 (katër muaj pas lidhjes së kontratës së sipërmarrjes), menjëherë pas disbursimit të kredisë së miratuar nga “Alpha Bank”. Ai ka deklaruar se shuma e dhënë hua nga vjehri ka pasur si burim të ardhurat nga biznesi i shtetasit N. J., i regjistruar në atë kohë si person fizik tatimpagues me NIPT ***, që ushtronte aktivitet “tregti me pakicë”. Ky fakt provohet me shkresën e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, paraqitur nga subjekti bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit standard¹³, e cila konfirmon se subjekti N. J. është regjistruar si subjekt person fizik më 25.3.2003 dhe çregjistruar në organin tatimor më 8.8.2008. Sipas kësaj shkrese, të ardhurat (qarkullimi) e realizuara për periudhën 2003 – 2006 janë në vlerën 12.300.000 lekë dhe subjekti fizik ka kryer pagesën e tatimit për këto të ardhura. Po kështu, me shkresën e Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore¹⁴ konfirmohet se subjekti tregtar ka likuiduar detyrimet vendore për periudhën në të cilën ka qenë aktiv, ndërsa për vitin 2007 ka paguar të gjitha detyrimet dhe taksat që rrjedhin prej ushtrimit të aktivitetit.

31. I pyetur gjatë procesit mbi mosdhënien e sqarimeve në deklaratën *Vetting* lidhur me këtë hua, subjekti ka deklaruar se në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting* kjo hua nuk ekzistonte. Sipas tij, si burim për të shlyer huan me vlerë 4.000 euro ka shërbyer kredia e marrë në “Alpha

¹²Shihni aktet në aneksin nr. 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së.

¹³Shkresë nr. *** prot., datë 19.9.2018.

¹⁴Shkresë nr. *** prot., datë 29.9.2018.

Bank” në vlerën 22.000 euro (konkretisht, shuma 3.878 euro, pasi shuma e mbetur prej 122 euro është likuiduar me të ardhurat e tij), kredi e cila është marrë vetëm 3-4 muaj pas marrjes së kësaj huaje. Subjekti i ka vërtetuar pretendimet me: (i) deklaratë noteriale nr. *** regj., nr. *** kol., datë 2.7.2007, e shtetasit N. J.; (ii) vërtetim nga “Alpha Bank”, lëshuar në datën 24.10.2022.

32. Në përfundim të hetimit administrativ, nga analiza e sqarimeve dhe dokumenteve të paraqitura në lidhje me huan 4.000 euro të marrë nga vjehri i subjektit, rezultoi se:

- ka një deklaratë noteriale në kohë reale të vitit 2007, në të cilën huadhënësi N. J. deklaroi dhënien e huas prej 4.000 euro subjektit që ai e ka përdorur për blerjen e apartamentit në vitin 2007;
- provohet kthimi i kësaj shume prej subjektit në rrugë bankare në datën 28.9.2007 me përshkrimin “kalim për N. J. për likuidim detyrimi”;
- provohet që shtetasi N. J. ka qenë subjekt tregtar/person fizik, i cili për periudhën 2003 – 2007 ka realizuar një qarkullim të konsiderueshëm të ardhurash dhe ka paguar të gjitha detyrimet ligjore, të cilat krijojnë besueshmërinë e justifikimit me të ardhura të ligjshme të huas prej 4.000 euro, dhënë subjektit të rivlerësimit përpara se ai të ishte prokuror;
- duke qenë se ky detyrim i është shlyer shtetasit N. J. që në datën e disbursimit të kredisë nga “Alpha Bank” 28.9.2007, në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting* ky detyrim nuk ka ekzistuar. Në këtë mënyrë justifikohet deklarimi i subjektit se si burim krijimi për pasurinë objekt verifikimi ka konsideruar vetëm kredinë e marrë në “Alpha Bank” në shumën 22.000 euro, duke mos e deklaruar specifikisht huan në vlerën 4.000 euro si burim më vete, hua e cila u vërtetua të jetë marrë dhe shlyer brenda vitit 2007, vit në të cilin nuk ka qenë subjekt deklarues.

33. Në lidhje me shpenzimet e mobilimit, në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar se: *“Apartamenti është mobiluar dhe pajisur me pajisje elektroshtëpiake në kohë të ndryshme, pjesë - pjesë sipas mundësive në vitet 2007 – 2013 dhe 2015 - 2016 me një vlerë totale të ulët, duke shpenzuar në total 750.000 lekë, jo më shumë se 100.000 – 150.000 lekë në një vit. Burim për blerjen e mobilieve dhe pajisjeve të shtëpisë janë të ardhurat nga paga të prindërve të mi (bashkëpronarë të apartamentit), dhurimi i mobilieve të dhomës së gjumit nga prindërit e bashkëshortes dhe kursimet nga të ardhurat e pagës sime dhe të bashkëshortes, me të cilën në kohën e blerjes së disa prej pajisjeve kemi shfrytëzuar një kredi në vlerë të vogël të marrë pranë në ‘Raiffeisen Bank’, e cila është likuiduar/shlyer prej kohësh”.* Në përfundim të hetimit administrativ, shpenzimet e mobilimit janë konsideruar se janë përballuar nga subjekti dhe janë përfshirë në analizën financiare të tij, me shpërndarjen e mëposhtme.

Vitet	2008	2009	2010	2011	2012	2015	2016	Total
Shpenzimi	100 000	100 000	100 000	100 000	100 000	100 000	150 000	750 000

Analiza financiare

34. Në tabelën vijuese janë paraqitur në mënyrë të përmbledhur burimet, të cilat kanë shërbyer për blerjen e pasurisë, sipas datave në të cilat është kryer çdo pagesë, bazuar në kontratën e sipërmarrjes dhe mandatarkëtimin e vitit 2005, kontratën e shitjes me rezervë të vitit 2007 dhe deklaratimet e subjektit.

Burimet e krijimit	Vlera sipas burimeve të deklaruara nga subjekti në <i>Vetting</i>	Vlera e investimit total e dekluaruar	Datat e pagesës së secilës shumë/datat e dhurimeve	Vlera e konsideruar nga Komisioni
Kursime të prindërve të subjektit	19 000	42 528 euro	29.9.2005	19 000 euro
Kursime të subjektit	1 000 euro			1 000 euro
Hua nga babai i bashkëshortes	4 000 euro		4.6.2007	4 000 euro

Kursime të babait/prindërve të subjektit	208 euro	4.6.2007	208 euro
Kredi bankare	17 900 euro ¹⁵	28.9.2007	17 900 euro
Kursime të babait/prindërve të subjektit	420 euro	2007	420 euro
Totali	42 528 euro		42 528 euro

35. Në analizën e burimeve të listuara në këtë tabelë, subjekti dhe prindërit e tij janë analizuar më vete, pasi për vitet 2004 deri në momentin e pagesës së plotë të apartamentit subjekti ka punuar në Durrës dhe në Fier, pra faktikisht larg familjes së tij dhe kontributi i tij i deklaruar ka qenë vetëm 1.000 euro, të cilën ia ka dhuruar babait¹⁶.

36. Në një analizë të shumave të paguara për blerjen e pasurisë rezultoi se:

- Shuma prej 17.900 euro e ka burimin në kredinë bankare marrë në “Alpha Bank” në vlerën 22.000 euro, pra është me burim të ligjshëm.

- Për pagesat e tjera u vërtetua mundësia financiare me të ardhura të ligjshme. Konkretisht: (i) sa i takon pagesës së shumave prej: 208 euro, datë 4.6.2007 dhe 420 euro brenda vitit 2007 nga babai i subjektit, ai ka pasur të ardhura të ligjshme t’i paguajë këto shuma; (ii) sa i takon mundësisë së subjektit për t’i dhënë babait të tij shumën 200.000 lekë (nga e cila babai ka paguar për apartamentin vlerën 1.000 euro), ai ka pasur mundësi ta kursejë këtë shumë nga paga e tij për vitet 2004 - 2005; (iii) sa i takon huas në vlerën 4.000 euro, marrë në vitin 2007 prej vjehrrit të subjektit Ndreko Jarazi, e cila është shlyer me kredinë e marrë brenda vitit 2007, u konsiderua me të ardhura të ligjshme; (iv) sa i takon mundësisë financiare për të paguar nga babai i subjektit shumën 19.000 euro në datën 29.9.2005, është kryer analiza financiare e familjes së subjektit bazuar në metodologjinë kumulative, nga viti 1981 kur janë dokumentuar të ardhura të prindërve deri në datën 29.9.2005, nga e cila duket se ka një balancë negative në shumën 58.262 lekë, e cila nuk është konsideruar si penalizuese për subjektin e rivlerësimit.

Përshkrimi	Total 1981 – 29.9.2005
Pasuri	2 750 829
Apartament me sip. 44.5 m ² , në K**, blerë më 15.6.1998	300 000
Apartament me sip. 88.6 m ² , *** paguar nga prindërit	2 328 260
Apartament me sip. 88.6 m ² , *** - nga subjekti	122 540
<i>Shtesa/Pakësime likuiditete</i>	29
Të ardhura dokumentuar	4 667 732
Të ardhura nga babai	2 379 241
Të ardhura nga nëna	2 088 491
Të ardhura nga vajza/motra e subjektit	0
Dhënë nga subjekti	200 000
Shpenzime	1 975 165
Shpenzime jetese sipas përbërjes familjare ¹⁷	1 575 165
Dhënë subjektit për të blerë automjetin	400 000
Mundësia për kursime	-58 262

¹⁵Shuma e disbursuar e kredisë bankare është 22.000 euro nga të cilat 17.900 euro janë kaluar në llogarinë e firmës ndërtuese/palës shitëse dhe 3.787 euro janë kaluar në llogarinë e babait të bashkëshortes (atëherë të lidhur) për kthimin e huas prej 4.000 euro.

¹⁶Në përgjigje të pyetësorit nr. 2 subjekti ka deklaruar: “Sqaroj se: ‘... kontributi im, konfirmuar edhe prej babait dhe nënës sime, për pagesën e shumës cash të apartamentit, ka qenë vetëm 1.000 euro...’ dhe ‘...babai im, kishte përdorur edhe 1.000 euro nga vlera prej rreth 200.000 lekë, të cilën unë i kisha dhënë prindërve pjesë-pjesë, gjatë periudhës dhjetor 2004 – shtator 2005...’”

¹⁷Janë zbritur nga niveli standard i shpenzimeve jetike vlera e grupit “ushqime dhe pije joalkoolike” që zë 47.6% të shpenzimeve totale për shkak të ekonomisë bujqësore nga disponimi i tokës bujqësore nga viti 1991.

37. Në këtë analizë janë përfshirë:

- të ardhurat e dokumentuara të prindërve të subjektit për gjithë periudhën.
- nuk janë përfshirë të ardhura të motrës së subjektit, pasi ai nuk ka paraqitur dokumentacion provues dhe është përfshirë si e ardhur shuma 200.000 lekë dhënë babait nga subjekti;
- shpenzimet e jetesës janë përlllogaritur sipas përbërjes familjare: nga viti 1991 deri në fund të vitit 1999 si 50% e të ardhurave familjare; nga viti 2000 deri në maj të vitit 2004 sipas standardit të ILDKPKI-së për 4 persona¹⁸; pas fillimit të punës së subjektit në Durrës dhe deri më 29.9.2005 për 3 persona. Është përfshirë si shpenzim dhurata e babait prej 400.000 lekësh për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz 250” të subjektit, deklaruar prej tij në deklaratën e vitit 2004. Shpenzimet e jetesës janë reduktuar me zërin “ushqime dhe pije joalkoolike” për shkak të disponimit të tokës bujqësore nga viti 1991 dhe përfitimi i produkteve bujqësore prej saj.

38. Pavarësisht justifikimit me të ardhura të ligjshme të shumës 42.528 euro, përcaktuar si çmimi i blerjes së pasurisë në kontratën e shitjes me rezervë, në përfundim të hetimit administrativ, me njoftimin e rezultateve të hetimit, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i është kërkuar të japë sqarime e dokumente në lidhje me konstatimet, duket se: (i) ka paqartësi në lidhje me çmimin real të blerjes së kësaj pasurie, pasi rezulton se ky çmim është më i ulët se çmimi i tregut; (ii) ka paqartësi mbi periudhën e saktë të pagesës së këstit të parë, pasi nga përshkrimi në kontratën e shitjes me rezervë të datës 4.6.2007, kësti prej 24.208 euro (19.000 euro kësti i parë + 4208 euro për punimet shtesë) është likuiduar në datën e lidhjes së kësaj kontrate, kurse në kontratën e sipërmarrjes të datës 29.9.2005 parashikohet që kësti i parë prej 19.000 euro do të realizohej në këtë datë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit

39. Lidhur me faktin se çmimi i blerjes së pasurisë duket të jetë më i ulët se çmimi i tregut, në parashtrimet e tij, subjekti pretendon se ky çmim nuk ka qenë më i ulët sesa çmimi i tregut. Sipas tij, udhëzimi i vitit 2005 që i referohet Komisioni nuk ka parashikuar një ndarje të çmimit sipas zonave të Tiranës dhe vetëm në vitet pasardhëse EKB-ja ka nxjerrë udhëzimet përkatëse. Më tej, ai sqaron se zona e *** nuk ka qenë zonë preferenciale për blerjen e apartamenteve dhe çmimet kanë qenë shumë të lira në krahasim me zonat e tjera të Tiranës. Kjo ka qenë një ndër arsytet e blerjes së apartamentit në këtë zonë prej tyre. Për të vërtetuar pretendimin e tij mbi vërtetësinë e çmimit të blerjes, subjekti ka paraqitur shkresën kthim-përgjigjeje të datës 16.12.2022 të ASHK Tirana Rurale 2, përmes së cilës ky institucion informon se: (i) nga të dhënat e 8 kontratave të rastësishme të analizuara në pallatin ku ndodhet apartamenti i subjektit, vlera e shitjes së apartamenteve në këtë pallat në vitin 2007 kur është regjistruar për herë të parë pallati ka qenë 41.000 lekë/m²; (ii) në atë kohë ligji nuk parashikonte çmim reference, por trajtohej me 2% të vlerës së shitjes së pasurisë.

40. Në analizë të parashtrimeve dhe dokumenteve që subjekti ka paraqitur, në përfundim të procesit Komisioni i vlerësoi bindëse pretendimet e subjektit bazuar në faktet dhe rrethanat si vijojnë:

- udhëzimi nr. 5, datë 23.11.2005 “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB-ja për vitin 2005” nuk ka parashikuar një ndarje për përcaktimin e çmimit të shitjes së tregut të lirë të banesave për vitin 2005 sipas zonave të Tiranës dhe kjo ndarje është parashikuar duke filluar nga viti 2008;

¹⁸Dy prindërit, subjekti dhe motra e tij.

- sipas kontratave të ngjashme¹⁹ të vëna në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit në seancë dëgjimore, çmimi 42.528 euro i paguar prej tij për sip. 95.8 m² është pak më i lartë se çmimi për metër katror në këto kontrata;
- sipas informacionit të ASHK-së, nga të dhënat e 8 kontratave të rastësishme të shitjes së apartamenteve, në pallatin ku ndodhet pasuria e subjektit rezulton që për vitin 2007 çmimi mesatar i zonës për pasuritë e llojit “apartament” të ketë qenë 41.000 lekë;
- është një fakt i ditur publikisht se zona e *** nuk ka qenë zonë preferenciale për blerjen e apartamenteve dhe çmimet kanë qenë shumë të lira në krahasim me zonat e tjera të Tiranës, për shkak të largësisë nga qendra dhe mungesës së theksuar të infrastrukturës.
- nga hetimi administrativ nuk rezultoi ndonjë situatë konflikti interesi midis subjektit të rivlerësimit si OPGJ dhe palës shitëse shoqërisë “****” sh.p.k. apo përfaqësuesit të saj G. K. I.

40.1 Bazuar në sa më sipër, Komisioni krijoi bindjen se çmimi i parashikuar në kontratën e sipërmarrjes 42.528 euro është një çmim real dhe në koherencë të plotë me çmimin e tregut dhe çmimet e blerjes së pasurive në kontrata të ngjashme në të njëjtën periudhë dhe në të njëjtën zonë.

41. Lidhur me periudhën e pagesës së shumës prej 24.208 euro subjekti i qëndron shpjegimeve të dhëna gjatë procesit të rivlerësimit se kjo shumë është paguar si vijon: vlera 20.000 euro është paguar me mandatarkëtimin datë 29.9.2005 dhe vlera 4.208 euro i është paguar shitësit në momentin që është rënë dakord për nënshkrimin e kontratës së shitjes me rezervë në datën 4.6.2007, si shkak i punimeve shtesë. Sa i përket kontratës së shitjes me rezervë datë 4.6.2007, subjekti parashtron se kjo kontratë është formuluar në mënyrë të pasaktë lidhur me mënyrën dhe kohën e pagesës së shumës 24.208 euro, pasi kjo shumë është paguar siç është përshkruar më lart. Sipas tij, kjo ka ndodhur për shkak të lapsusit të noteres, pasaktësi që nuk është vënë re dhe nuk i është kushtuar vëmendje prej tyre, pasi, sipas tij, nuk përbënte ndonjë element të rëndësishëm për aktin e kalimit të pronësisë, i cili ka qenë edhe qëllimi kryesor i kontratës.

42. Në analizë të parashtrimeve të subjektit, por edhe në një vlerësim tërësor të të gjitha rrethanave, çmohet se kësti i parë prej 20.000 euro është paguar ditën e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes në datën 29.9.2005 dhe jo në datën 4.6.2007 kur është lidhur kontrata e shitjes me rezervë, datë në të cilën është paguar vetëm shuma 4.208 euro e punimeve shtesë (për të dyja këto shuma në përfundim të procesit të rivlerësimit është vërtetuar se janë krijuar me burime të ligjshme). Për të arritur në këtë përfundim, Komisioni iu referua fakteve si vijojnë:

- kontrata e sipërmarrjes e cila parashikon *se kësti i parë me vlerë 20.000 euro u pagua sot me lidhjen e kontratës* dhe mandatarkëtimi me datë 29.9.2005 janë prova shkruesore që vërtetojnë pagimin e këstit me vlerë 20.000 euro në këtë datë;
- administratori i shoqërisë “****” sh.p.k., G. I., ka konfirmuar këtë mënyrë të pagesës së çmimit të shitjes sipas deklarimeve të subjektit;
- fakti që babai i subjektit dhe subjekti nuk kanë qenë subjekte deklaruese në vitet 2005 dhe 2007 (pra, nuk kanë pasur detyrimin për të deklaruar pagesat apo pakësimin e likuiditeteve për blerjen e pasurisë), justifikon mungesën e një kujdesi të shtuar për të lexuar me vëmendje kontratën e shitjes me rezervë, duke bërë të besueshëm pretendimin e subjektit që pasaktësia në redaktimin e kontratës në lidhje me likuidimin e këstit të parë të çmimit të shitjes, nuk është vënë re prej tyre në procesin e nënshkrimit të aktit noterial.

43. Por, pavarësisht sa më sipër, për një vlerësim sa më objektiv të çështjes, Komisioni kreu analizën financiare edhe në variantin që shuma 24.208 euro (20.000 euro kësti i parë dhe 4.208 vlera e punimeve shtesë) është paguar tërësisht në vitin 2007, sipas parashikimit të kontratës së shitjes me rezervë. Sipas analizës kumulative të përmbledhur në tabelën më poshtë, rezulton se

¹⁹Kontratë sipërmarrjeje nr. ***, datë 13.11.2004, për shitjen e apartamentit me sip. 87.2 m², me çmimin 32.264 euro (çmimi 370 euro/m²); kontratë sipërmarrjeje nr. ***, datë 25.5.2005, për shitjen e apartamentit me sip. 87.6 m², me çmimin 35.040 euro (çmimi 400 euro/m²).

subjekti me familjen e tij kanë pasur mundësi me të ardhura të ligjshme për të paguar këtë shumë me të ardhura të ligjshme.

Përshkrimi	Total periudha 1981 – 2007
Pasuri	5 452 189
Apartament me sip. 44.5 m ² në K****, blerë më 15.6.1998	300 000
Apartament me sip. 88.6 m ² , *** paguar nga prindërit	4,537 510
Apartament me sip. 88.6 m ² , *** nga subjekti	604 550
<i>Shtesa/Pakësime likuiditete</i>	10 128
Të ardhura dokumentuar	8 992 392
Të ardhura nga babai	3 291 337
Të ardhura nga nëna	2 841 035
Të ardhura nga vajza/motra e subjektit	0
Dhënë nga subjekti	200 000
Kredi 22.000 euro në “Alpha Bank” më 28.9.2007, për 20 vjet	2 660 020
Shpenzime	3 050 376
Shpenzime jetese sipas përbërjes familjare ²⁰	2 623 582
Dhënë subjektit për të blerë automjetin	400 000
Shpenzime të tjera	26 794
Mundësia për kursime	489 828

44. Në procesin e vlerësimit përfundimtar çmohet se kontrata e shitjes me rezervë e pasurisë, datë 4.7.2007, ka një pasaktësi në përshkrimin e likuidimit të kështit të parë, konkretisht, shumës 24.208 euro dhe subjekti është treguar i pakujdesshëm në procesin e nënshkrimit të aktit noterial. Por, bazuar në një vlerësim tërësor të fakteve dhe rrethanave, arsyetuar hollësisht më sipër në këtë vendim, Komisioni krijoi bindjen se kjo pasaktësi nuk ka sjellë asnjë pasojë, pasi mungon ana subjektive/qëllimi i subjektit për të fshehur një pagesë të pajustificuar me të ardhura të ligjshme. Për më tepër, u vërtetua se procedurat për blerjen kanë nisur në vitin 2005 vetëm nga babai i subjektit dhe kanë përfunduar në vitin 2007, kur subjekti është bërë blerës së bashku me babain pensionist për shkak të kredisë së marrë në “Alpha Bank”, vite në të cilat subjekti nuk ka ushtruar detyrën e prokurorit.

45. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: “*Apartament banimi, në përdorim, me sipërfaqe 96 m², me nr. 70, kati V nga toka, me adresë në Vlorë, lagje ‘***’, banesa ***-*** kate, marrë me qira sipas kontratës nr. *** rep., nr. *** kol., datë 20.1.2017. Vlera e qirasë 8.000 lekë/muaj*”. ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika në lidhje me këtë pasuri.

46. Në lidhje me marrëdhënien e qirasë, nga verifikimi i dokumenteve²¹ rezultoi se:

- sipas certifikatës për vërtetim pronësie datë 26.6.2012, rezulton e regjistruar në pronësi të shoqërisë “****” sh.p.k. pasuria nr. ***, z. k. ***, Vlorë, e llojit “apartament” me sip. 96 m²;
- nga ekstrakti i QKB-së shoqëria “****” sh.p.k. ushtron aktivitetin tregtar në fushën e tregtisë dhe transportit, me adresë në lagjen “****”, Vlorë;

²⁰Janë zbritur nga niveli standard i shpenzimeve jetike vlera e grupit “ushqime dhe pije joalkoolike” që zë 47.6% të shpenzimeve totale për shkak të ekonomisë bujqësore nga disponimi i tokës bujqësore nga viti 1991.

²¹Shihni aktet në aneksin nr. 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së.

- sipas kontratës së qirasë nr.***, datë 20.1.2017, subjekti Elion Mustafaj ka marrë me qira nga shoqëria “***” sh.p.k. apartamentin me nr. pasurie ***, ku vlera e qirasë është 8.000 lekë/muaj dhe kjo kontratë qiraje ka filluar në datën 1.3.2016 dhe përfundon në datën 31.12.2017;

- përdorimi i këtij apartamenti me qira është deklaruar nga subjekti në DPV-të 2016 dhe 2017;

- me deklaratën noteriale nr. ***, datë 7.3.2018, administratori i shoqërisë “***” sh.p.k., z. S. F., ka deklaruar se meqenëse qiramarrësi Elion Mustafaj u largua për një periudhë relativisht të gjatë, u ra dakord që marrëdhënia e qirasë të përfundonte në datën 30.4.2017;

- nga verifikimet e kryera në drejtim të ndonjë konflikti të mundshëm interesi mbi çështje të trajtuara nga subjekti, ku palë pjesëmarrëse me çfarëdolloj statusi është shoqëria “***” sh.p.k., administratori i saj S. F. dhe ortaku L. Z., nuk rezultuan të dhëna²².

47. Subjekti ka deklaruar: *“Llogari në euro në ‘Raiffeisen Bank’ me gjendje në shumën 5.581.61 euro, me burim krijimi shitjen e autoveturës. Pjesa takuese: 50% (llogaria është në emrin tim, por shuma monetare në fjalë në këtë llogari është në bashkëpronësi me bashkëshorten)”*. ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika në lidhje me këtë pasuri.

48. Nga verifikimi i dokumentacionit bankar u konstatua se kjo llogari është çelur në datën 29.4.2016. Në lidhje me burimin e krijimit “shitja e autoveturës”, nga aktet e administruara²³ rezultoi se me kontratën e shitblerjes së automjetit nr. ***, datë 30.4.2016, subjekti i ka shitur shtetasit E. D. automjetin tip “Mercedes-Benz”, me targa ***, me nr. shasie ***, në çmimin 12.000 euro, kaluar në rrugë bankare në llogari të subjektit, sipas aktit “nxjerrje llogarie” të “Raiffeisen Bank”, ku evidentohet veprimi i datës 29.4.2014, me përshkrimin “E. D. derdhje për blerje makine”²⁴. Në emër të shtetasit E. D. nuk rezultojnë të regjistruara kallëzime/procedime penale të hetuara nga prokurori Elion Mustafaj²⁵.

49. Nga verifikimi i deklarimeve periodike konstatohet se në DPV/2016 (plotësuar në datën 27.3.2017), në rubrikën “ndryshimet e pasurive” është deklaruar: *“Pakësuar pasuria e luajtshme autoveturë ‘Mercedes-Benz’, me targa ***, për shkak të shitjes sipas kontratës së shitblerjes së automjetit datë 30.4.2016. Vlera: 12.000 euro”*. Në të njëjtën rubrikë, në vijim është deklaruar: *“Shtuar likuiditet në shumën 12.000 euro, nga shitja e autoveturës së mësipërme me targa ***. Shuma monetare në fjalë e shitjes së autoveturës është derdhur prej blerësit në llogarinë rrjedhëse në euro, pranë ‘Raiffeisen Bank’. Më 31.12.2016, kjo shumë monetare prej 12.000 euro, disponohet e ndarë dhe konkretisht: shuma monetare prej 5.584.47 euro është gjendje në llogarinë rrjedhëse pranë ‘Raiffeisen Bank’; shuma monetare prej 6.400 euro është gjendje cash; pjesa tjetër e vogël e mbetur është debituar nga banka si tatim/komision për mirëmbajtje llogarie, etj. Pjesa takuese: 50%”*.

- DPSHTRR-ja²⁶ ka konfirmuar se ky automjet ka qenë i regjistruar në emër të shtetasit Elion Mustafaj, ndërsa aktualisht nuk ka mjet të regjistruar.

50. Në përfundim të hetimit administrativ rezultoi se deklaratimet e subjektit për depozitën bankare në shumën 6.400 euro dhe burimin e saj janë të sakta.

51. Në lidhje me mënyrën e përfitimit të automjetit me targa *, shitur në datën 29.4.2016, në shumën 12.000 euro, si dhe burimet e krijimit të tij, rezultoi se:**

²²Shihni shkresën kthim-përgjigjeje nr. *** prot., datë 12.10.2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë; shkresën kthim-përgjigjeje nr. *** prot., datë 18.10.2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë në dosjen e Komisionit.

²³Shihni aktet në aneksin nr. 4/3 në dosjen e ILDKPKI-së.

²⁴Shihni dokumentin bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2 në dosjen e Komisionit.

²⁵Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 18.10.2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 12.10.2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë; shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 3.11.2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec në dosjen e Komisionit.

²⁶Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 3.3.2021, nga DPSHTRR-ja në dosjen e Komisionit.

51.1 Me kontratë shitjeje nr. ***, datë 12.1.2015, subjekti Elion Mustafaj ka blerë nga shtetasi R.K. automjetin tip “Mercedes-Benz”, me targa ***, me nr. shasio ***, në shumën 10.000 euro, e cila do të paguhet me mandat banke në datën 12.1.2015. Pas kërkesës së Komisionit, subjekti paraqiti²⁷ kopjen e një dokumenti bankar me titull “depozitë në arkë”, lëshuar në datën 12.1.2015 nga “Tirana Bank”, dega Korçë, për depozitim të shumës 10.000 euro. Në emër të shtetasit R. K. nuk rezultojnë të regjistruara kallëzime/procedime penale të hetuara nga prokurori Elion Mustafaj²⁸. I pyetur mbi rrethanat e shitjes së këtij automjeti pas një viti e gjysmë, në datën 30.4.2016, në çmimin prej 12.000 euro, pra 2.000 euro më shtrenjtë nga sa është blerë, subjekti ka sqaruar²⁹ se gjatë kohës që e ka pasur në pronësi këtë automjet ka investuar në të, duke vendosur goma të reja me vlerë rreth 50.000 lekë, por ka kryer edhe shpenzimet e regjistrimit të tij, mirëmbajtjes teknike etj. Shuma 2.000 euro (diferenca e çmimit të shitjes me atë të blerjes) është përfshirë në analizën financiare si shpenzim i kryer nga subjekti për periudhën shkurt 2015 – prill 2016, duke e ndarë këtë shumë në mënyrë të barabartë për secilin vit.

51.2 Në DPV/2015 subjekti ka deklaruar blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz” me targa *** në shumën 10.000 euro, duke deklaruar gjithashtu pakësimin e gjendjes *cash* të deklaruar më parë në shumën 10.000 euro për blerjen e këtij automjeti.

51.3 Në DPF/2012 subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në vlerën 1.300.000 lekë. Për të verifikuar mundësinë e subjektit për krijimin e kësaj shume është kryer analiza financiare e subjektit nga maji i vitit 2004 kur ka filluar detyrën si kancelar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës deri më 4.6.2012 kur ka filluar detyrën si prokuror, bazuar në metodologjinë kumulative, sikurse është treguar në tabelën më poshtë. Siç vërehet, ka një balancë negative prej 629.143 lekësh. Meqenëse gjendja *cash* e krijuar para detyrës është mbartur brenda periudhës së detyrës, pasi ka shërbyer si burim për blerjen e automjetit në vitin 2015, kjo pamundësi e subjektit është reflektuar në analizën financiare të vitit 2012, vit i cili ka rezultuar me balancë negative³⁰.

Përshkrimi	Periudha maj 2004 – 4.6.2012
Pasuri	2 240 781
Automjet tip “Mercedes-Benz 250”, prodhim i vitit 1988 – deklaruar në DPV/2004	700 000
Automjet tip “Mercedes-Benz”, me targa ***, blerë më 4.6.2008	200 000
<i>Shtesa/pakësime likuiditete</i>	<i>1 340 781</i>
Të ardhura dokumentuar	9 728 083
Të ardhura nga paga e subjektit nga maj 2004	5 434 182
Të ardhura nga paga e bashkëshortes nga data e martesës	474 516
Dhënë nga prindërit për blerjen e automjetit	400 000
Kredi 22.000 euro në “Alpha Bank”, datë 28.9.2007, për 20 vjet	2 660 020
Kredi në “Raiffeisen Bank”, datë 14.5.2007, 4 vjet	103 000
Hua nga vjehri 4.000 euro	483 640
Të ardhura të motrës për vitin 2012	132 000

²⁷Shihni dokumentin bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2 në dosjen e Komisionit.

²⁸Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 18.10.2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 12.10.2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë; shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 3.11.2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec në dosjen e Komisionit.

²⁹Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 2 në dosjen e Komisionit.

³⁰Shihni tabela përmbledhëse në fund të kriterit të pasurisë.

Likuiditetet e mbartura nga bashkëshortja para martesës	40 725
Shpenzime	8 116 445
Shpenzime jetese sipas përbërjes familjare	1 624 729
Shpenzime udhëtimi <i>TIMS</i>	1 326 042
Dhënë babait për blerje apartamenti me sip. 88.6 m ² , ***	2 847 929 ³¹
Kthyer huaja vjehrit	483 640
Paguar kredia tek “Alpha Bank”	1 162 158
Paguar kredia tek “Raiffeisen Bank”	150 663
Shpenzime mobilimi sipas pyetësorit standard	450 000
Komisione bankare	29 794
Dërguar me MoneyGram	41 490
Mundësia për kursime	-629 143

Në këtë analizë janë përfshirë:

- të ardhurat e subjektit për periudhën e analizuar;
- të ardhurat e dokumentuara të bashkëshortes nga data e martesës së tyre qershor 2009;
- shpenzimet e jetesës sipas standardit të ILDKPKI-së dhe përbërjes familjare: maj 2004 vetëm subjekti; në qershor 2009 shtohet bashkëshortja; në maj 2011 lind vajza dhe në vitin 2012 shtohet edhe motra e subjektit, e cila ka shkuar të banojë me të³².
- të ardhura të motrës së tij qe sipas *statement*-i bankar të BKT-së³³, ku ka kaluar paga e motrës së tij janë nga tetori i vitit 2009 deri në vitin 2015;
- likuiditetet e të gjithë pjesëtarëve të familjes që kanë jetuar së bashku në këtë periudhë.

52. Në përfundim të hetimit administrativ, duket se subjekti nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar shumën *cash* prej 1.300.000 lekësh (e cila ka shërbyer si burim për blerjen e automjetit me targa *** në vitin 2015), për shkak të një balance negative prej 629.143 lekësh. Sipas nenit 52 të ligjit nr. 84.2016, subjektit i kaloi barra e provës për të vërtetuar të kundërtën e këtij konstatimi.

53. Në parashtrimet e tij subjekti ka kundërshtar balancën negative, duke pretenduar se në analizën e Komisionit ka disa pasaktësi, pretendime të cilat Komisioni i analizoi si vijon:

53.1 Në lidhje me shpenzimet e udhëtimit, subjekti pretendoi se nuk duhet të llogariten si shpenzime udhëtimet jashtë vendit të kryera për nevoja pune, për sa kohë këto shpenzime janë mbuluar nga Prokuroria e Përgjithshme ose organizatorët e aktiviteteve, si dhe ka kërkuar të merret në konsideratë fakti i qëndrimit tek të afërmit. Në mbështetje të pretendimeve të tij ka depozituar dokumentacion për udhëtimet e punës³⁴ si: (i) vërtetim nga shoqëria “***” sh.p.k.³⁵ për sponsorizimin e udhëtimit; (ii) deklaratë noteriale të datës 22.12.2020³⁶, në formën e kërkuar nga ligji të dajës së tij në lidhje me mbulimin e shpenzimeve dhe akomodimin gjatë kohës së qëndrimit në SHBA.

³¹Konkretisht shumat: 200.000 lekë, dhënë më 29.9.2005; 4.000 euro huaja e marrë nga vjehri dhe 17.900 euro kredia e marrë në “Alpha Bank”.

³²Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 2, administruar në dosjen e Komisionit.

³³ Shihni dokumentin ne përgjigje të pyetësorit nr. 4, administruar në dosjen e Komisionit.

³⁴Urdhër nr. ***, datë 30.7.2008, i Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm; program datë 30.7.2008, i Drejtorisë së Marrëdhënieve me Jashtë të Prokurorisë së Përgjithshme; urdhër nr. ***, datë 1.10.2008, i Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm; lista e pjesëmarrësve në këtë konferencë, në gjuhë të huaj; “agenda” e programit për periudhën 16-30 maj 2009, në gjuhën anglisht; dokumente të tjera që vërtetojnë vizitën zyrtare në SHBA; program datë 25.1.2011, miratuar nga Prokurori i Përgjithshëm; urdhër nr. ***, datë 15.2.2011, i Sekretarit të Përgjithshëm të Prokurorisë së Përgjithshme.

³⁵Vërtetim nr. ***, datë 30.7.2018, i subjektit “***” sh.p.k., si dhe dokumenti i regjistrimit të mjetit të udhëtimit.

³⁶Deklaratë datë 22.12.2020, e dajës E. H., para noterit publik në SHBA, me vulë apostile.

Nga analiza e sqarimeve dhe dokumenteve të paraqitura vlerësohet se në pjesën më të madhe, pretendimet e subjektit qëndrojnë dhe provohen. Konkretisht:

- Për udhëtimin nr. 1 nuk qëndron pretendimi, pasi Komisioni nuk kishte llogaritur shpenzime.
- Për udhëtimin nr. 2 qëndron pretendimi dhe shpenzimet janë zbritur me 180 euro.
- Për udhëtimin nr. 3 pretendimi i subjektit se është një udhëtim pune dhe nuk duhen llogaritur shpenzime, qëndron pjesërisht, pasi vetë subjekti deklaroi se në këtë udhëtim pune ka ndryshuar itinerarin dhe për një periudhë 10-ditore ka qëndruar tek i afërmi i tij. Në këto kushte, ky udhëtim nuk është konsideruar nga Komisioni me 0 (zero) euro shpenzime, por ato janë llogaritur sipas standardit të Kolegjit për çmimin e biletës dhe shpenzimet ditore të qëndrimit të të afërmit. Në total shpenzimet e paguara nga subjekti sipas përlllogaritjes kanë rezultuar 256 euro.
- Për udhëtimin nr. 4 subjekti pretendon se ai dhe bashkëshortja e tij kanë qenë për pushime dhe udhëtimi është paguar si bonus/shpërblim nga punëdhënësi i bashkëshortes dhe, për rrjedhojë, nuk duhet llogaritur si shpenzim. Duke pasur në konsideratë që në vitin 2009 subjekti dhe bashkëshortja e tij nuk kanë qenë subjekte deklaruese, Komisioni e mori në konsideratë këtë pretendim dhe ka zbritur shpenzimet me 900 euro.
- Për udhëtimin nr. 5, ashtu si dhe subjekti, Komisioni ka ripërlllogaritur shpenzimet në shumën 1.277 euro sipas standardit të Kolegjit në rastin e mbulimit të shpenzimeve të qëndrimit të të afërmit, provuar kjo në rastin konkret me deklaratën noteriale të datës 22.12.2020 të dajës së tij.
- Për udhëtimin nr. 6 qëndron pretendimi i subjektit se është një udhëtim pune dhe Komisioni e ka marrë në konsideratë atë, duke zbritur shpenzimet me 580 euro.

Ndryshimet e mësipërme janë pasqyruar në analizën e rishikuar nga Komisioni.

53.2 Subjekti ka pretenduar se të gjitha pagesat e kësteve të kredisë pranë “Alpha Bank” nga prindërit në periudhën 2007 – 2012 i janë ngarkuar atij, ndërkohë që jo të gjitha pagesat janë kryer prej tij. Pretendimet e tij qëndrojnë dhe janë të dokumentuara edhe në lëvizjet bankare të llogarisë së kredisë, nga verifikimi i të cilave rezultoi se në total subjekti për këtë periudhë ka paguar 5.065,5 euro dhe prindërit e tij 3.768 euro, shumë nuk është konsideruar si shpenzim i subjektit në analizën financiare të rishikuar.

53.3 Në lidhje me të ardhurat e bashkëshortes, subjekti pretendoi se të ardhurat nga paga e saj nuk janë përfshirë për të gjithë periudhën. Konkretisht, pretendoi të ardhura të saj, si vijojnë:

a) Të ardhura nga punësimi në shoqërinë “****” sh.p.k. për periudhën 2009 – 2011 në shumën 552.000 lekë. Për të vërtetuar këtë pretendim subjekti i referohet vërtetimit nga shoqëria “****” sh.p.k., të depozituar në deklaratën *Vetting* dhe llogarive bankare të risjella në prapësime. Gjithashtu, subjekti në seancë dëgjimore ka depozituar vërtetimin nr. *** prot., datë 20.12.2022, të Degës së Arkivit të Rajonit Tiranë, mbi bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare nga ISSH-ja të bashkëshortes, i cili konfirmon periudhën e punësimit nga data 1.10.2007 deri në vitin 2012 në shoqërinë “****” sh.p.k. Komisioni ka përfshirë në analizën e rishikuar të ardhurat prej 552.000 lekësh.

b) Në lidhje me të ardhurat e bashkëshortes nga punësimi në shoqërinë “****” sh.p.k., subjekti për periudhën 2010 - 2011 ka pretenduar shumën 532.800 lekë. Këtë pretendim e ka mbështetur në vërtetimin e ISSH-së Tiranë, paraqitur në seancë, i cili konfirmon punësimin për periudhën maj 2010 - dhjetor 2011 me pagë *bruto* 30.000 lekë. Komisioni ka përfshirë në analizën e rishikuar të ardhurat prej 532.800 lekësh (26.640 lekë³⁷ paga *neto* e përlllogaritur nga Komisioni x 20 muaj = 532.800 lekë).

³⁷Nga paga *bruto* janë zbritur 11.2% kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

53.4 Subjekti pretendon se të ardhurat për vitin 2009 në shumën 100.000 lekë, dhuruar nga prindërit e bashkëshortes³⁸, nuk janë përfshirë në analizë. Komisioni e ka marrë në konsideratë këtë pretendim, pasi subjekti dhe bashkëshortja e tij nuk kanë qenë subjekte deklaruese dhe nuk kanë pasur detyrim për deklarim të dhuratave në vitin 2009. Gjithashtu, ky fakt është deklaruar nga subjekti në mënyrë të vazhdueshme në shpjegimet e dhëna para inspektorit të ILDKPKI-së në vitin 2016, në deklaratën e rivlerësimit të dorëzuar në vitin 2017 dhe në shpjegimet e dhëna në pyetësorin standard nr. 1, lidhur me shpenzimet e mobilimit.

53.5 Në përfundim, me ndihmën e Njesisë së Shërbimit Ligjor, Komisioni kreu analizën e rishikuar financiare si në tabelën më poshtë, nga ku mori në konsideratë: zbritjen e shpenzimeve të udhëtimit nga 1.326.042 lekë në 551.058 lekë; zbritjen e shpenzimeve për pagesën e kësteve nga 1.162.158 lekë në 666.843 lekë; shtimin e të ardhurave të bashkëshortes nga 474.516 lekë në 1.561.716 lekë; dhe shtimin e të ardhurave nga dhurimi i prindërve të bashkëshortes me 100.000 lekë për vitin 2009, nga ku balanca negative prej -629.143 lekësh për periudhën para fillimit të detyrës u kthye në një balancë pozitive për shkak se mundësia për kursime rezultoi në vlerën 1.828.356 lekë. Për rrjedhojë, subjekti ka pasur burime të mjaftueshme financiare për të krijuar gjendjen *cash* në vlerën 1.300.000 lekë, deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës, e cila ka shërbyer si burim për blerjen e automjetit në vitin 2015 në çmimin 10.000 euro. Ligjshmëria e burimeve për krijimin e shumës 1.300.000 lekë si gjendje *cash*, mbartur nga subjekti në datën 4.6.2012 me fillimin e detyrës, ndikon edhe në analizën financiare për vitin 2012, e cila pas rishikimit ka rezultuar me balancë pozitive.

	<i>Periudha maj 2004 – 4.6.2012</i>
Pasuri	2,240,781
Automjet tip “Mercedes-Benz 250”, prodhim i vitit 1988 – deklaruar në DPV/2004	700,000
Automjet tip “Mercedes-Benz”, me targa ***, blerë më 4.6.2008	200,000
<i>Shtesa/pakësime likuiditete</i>	<i>1,340,781</i>
Likuiditete gjendje	
Të ardhura, dokumentuar	10,915,283
Të ardhura nga paga e subjektit nga maj 2004	5,434,182
Të ardhura nga paga e bashkëshortes	1,561,716
Dhënë nga prindërit e bashkëshortes për dhomë gjumi	100,000
Dhënë nga prindërit për blerje automjeti	400,000
Kredi 22.000 euro “Alpha Bank”, datë 28.9.2007, për 20 vjet	2,660,020
Kredi në “Raiffeisen Bank”, datë 14.5.2007, për 4 vjet	103,000
Hua nga vjehri	483,640
Të ardhura të motrës, viti 2012	132,000
Likuiditete të mbartura nga bashkëshortja para martesës	40,725
Shpenzime	6,846,146
Shpenzime jetese	1,624,729
Shpenzime udhëtimi <i>TIMS</i>	551,058
Dhënë babait për blerje apartamenti me sip. 88.6 m ² , ***	2,847,929
Kthyer huaja vjehrit	483,640
Paguar kredia tek “Alpha Bank”	666,843

³⁸E ardhur e cila është përdorur për blerjen e dhomës së gjumit me burim kursimet nga paga e bashkëshortes para martesës.

Paguar kredia tek "Raiffeisen Bank"	150,663
Shpenzime qiraje	0
Shpenzime mobilimi, deklarata <i>Vetting</i> + pyetësori standard	450,000
Shpenzime transporti	0
Dërguar me MoneyGram	41,490
Shpenzime të tjera	29,794
Mundësia për kursime	1,828,356
Mundësia për kursime kumulative	

54. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: "Llogari rrjedhëse e pagës në lekë pranë 'Credins Bank' (llogaria e pagës). Vlera 943.41 lekë. Pjesa takuese: 100%". Përputhet deklarimi i subjektit me të dhënat e "Credins Bank".

55. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: "Gjendje cash në shumën 200.000 lekë, me burim krijimi të ardhurat nga paga im dhe e bashkëshortes (kursime). Pjesa takuese: 50%". Subjekti ka pasur mundësi të krijojë një shtesë prej 150.000 lekësh³⁹ deri në datën 24.1.2017, me kursime nga pagat e tij dhe e bashkëshortes.

56. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: "Gjendje cash në shumën 6.400 euro, në bashkëpronësi me bashkëshorten, me burim krijimi të ardhurat nga shitja e automjetit. Pjesa takuese: 50%". Trajtuar në paragrafët 49-50 të këtij vendimi.

Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë

57. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: "Kredi me afat 20 vjet, në shumën 22.000 euro, marrë në vitin 2007 nga 'Alpha Bank - Albania' për blerje apartamenti banimi me sipërfaqe 88.6 m² me adresë në ***, Tiranë, deklaruar më sipër, regjistruar pranë ZVRPP-së Tiranë me nr. pasurie ***, vol. ***, f. ***, z. k. ***". Subjekti ka përshkruar mënyrën e marrjes së kredisë, duke përshkruar dhe bashkëlidhur të gjitha kontratat e lidhura në funksion të saj. Kjo kredi është trajtuar në paragrafin nr. 28 të vendimit.

Deklaratë e pasurisë së personit të lidhur N. M. – bashkëshortja e subjektit

58. Znj. N. M. ka nënshkruar autorizimin për kontrollin e deklaratës së interesave, por pa deklaruar nëse disponon ose jo pasuri veçmas të regjistruara në emrin e saj. Ajo ka deklaruar në deklaratën *Vetting* dy llogari bankare: (i) llogari rrjedhëse e pagës në lekë pranë "Credins Bank". Vlera: 16.184,02 lekë; 100%. Përputhet deklarimi i subjektit me të dhënat e "Credins Bank"; (ii) llogari Student Card pranë "Credins Bank". Vlera: 417.65 lekë; 100%. Përputhet deklarimi i subjektit me të dhënat e "Credins Bank".

59. Gjithashtu bashkëshortja e subjektit ka deklaruar: "Autoveturë në përdorim, me targa ***, marka 'BMW', tipi '***', emërtimi tregtar ***, viti i prodhimit 1999. Vlera: 120 000 lekë; 0%". ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika në lidhje me këtë pasuri të regjistruar në pronësi të babait të subjektit.

60. Nga hetimi administrativ u kryen disa veprime verifikuese, nga të cilat ka rezultuar se:

- DPSHTRR-ja⁴⁰ nuk ka konfirmuar automjet të regjistruar në emër të shtetasës N. M., por ka konfirmuar të regjistruar automjetin me targa *** në emër të shtetasit E. M. (babai i subjektit), i cili, me kontratë shitjeje nr. ***, datë 19.4.2016, e ka blerë këtë automjet nga shtetasi A. I., me

³⁹Shuma 50.000 lekë është mbartur nga viti 2016.

⁴⁰Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 3.3.2021 dhe shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 23.11.2021, nga DPSHTRR-ja në dosjen e Komisionit.

çmim 120.000 lekë. Nuk rezultojnë të regjistruara kallëzime/procedime penale për shtetasin A. I., të hetuara nga prokurori Elion Mustafaj⁴¹.

- I pyetur gjatë procesit të rivlerësimit mbi arsyet e përdorimit të këtij automjeti nga bashkëshortja, subjekti ka informuar se bashkëshortja e tij e ka përdorur këtë automjet për nevoja të saj dhe për t'iu shërbyer prindërve të tij për nevojat e tyre. Ndërsa, sa i takon burimit të krijimit, ai ka deklaruar se si burim kanë shërbyer të ardhurat nga pagat e prindërve të tij, dhe nga hetimi administrativ ka rezultuar se ata kanë pasur të ardhura për të blerë këtë automjet në vitin 2016.

Konstatime të tjera

61. Komisioni verifikoi deklaratimet e gjendjeve *cash* ndër vite nga subjekti dhe nga analiza financiare e periudhës së rivlerësimit konstatoi se ato janë të sakta dhe se justifikohen me të ardhura të ligjshme (me përjashtim të disa balancave negative në vlera të pakonsiderueshme).

62. Në DPV/2014 subjekti ka deklaruar: “*Shitje autoveture ‘Mercedes-Benz’, tipi ***, viti i prodhimit 1988, me targa ***, sipas kontratës nr. ***, datë 3.9.2014, në shumën 1.000 euro*”. Më tej është deklaruar: “*Shtuar likuiditet me 1.000 euro nga shitja e autoveturës ‘Mercedes-Benz’ dhe 120.000 lekë nga të ardhurat familjare vjetore*”. Në lidhje me këtë automjet u kryen verifikimet si vijojnë:

62.1 Ky deklaram vërtetohet me kontratën e shitblerjes nr.***, datë 3.9.2014, vënë në dispozicion nga DPSHTRR-ja⁴², e cila ka konfirmuar se ky automjet ka qenë i regjistruar në emër të z. Elion Mustafaj, ndërsa aktualisht nuk ka automjet të regjistruar. Nuk rezultojnë të regjistruara kallëzime/procedime penale për shtetasin A. B., të hetuara nga prokurori Elion Mustafaj⁴³.

62.2 Gjatë procesit, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti deklaroi se ky automjet i shitur në vitin 2014 te shtetasi A. B., ishte blerë prej tij në vitin 2004 nga shtetasi I. T., me çmimin 700.000 lekë, fakt që vërtetohet edhe me deklaratën e vitit 2004 në detyrën e kancelarit të Prokurorisë së Rrethit Durrës, ku subjekti ka deklaruar: “*Autoveturë e përdorur, tipi ‘Mercedes-Benz 250’, prodhim i vitit 1988. Vlera: 700.000 lekë. Viti i krijimit 2004*”. Ky automjet është deklaruar edhe në deklaratën e vitit 2012 si “*makinë tip ‘Benz’ (deklaruar më parë), pjesë takuese 100%*”.

62.3 Sipas subjektit, blerja e automjetit në vitin 2004 nga shtetasi I. T. në çmimin 700.000 lekë është bërë me marrëveshje të tyre, por pa një kontratë shitjeje. Subjekti deklaroi që për shkak të disa rrethanave për të cilat ka dhënë shpjegime të detajuara, midis tyre për këtë automjet, është lidhur kontrata e shitjes në vitin 2008 me aktin noterial nr. ***, datë 4.6.2008, me vlerë 200.000 lekë, kontratë e cila është regjistruar në DPSHTRR.

62.4 Pavarësisht këtyre deklarimeve, Komisioni verifikoi mundësinë e krijimit të shumës prej 700.000 lekësh për blerjen e automjetit në vitin 2004, duke iu referuar deklarimeve të subjektit në DPV/2004 si kancelar, të mbështetura edhe gjatë procesit. Si burim të kësaj shume subjekti ka deklaruar të ardhurat nga pagat e tij në shumën 300.000 lekë dhe të prindërve në shumën 400.000 lekë, duke paraqitur disa dokumente shkresore⁴⁴. Pas verifikimeve, nëpërmjet analizave financiare përkatëse të kryera me ndihmën e Njësisë së Shërbimit Ligjor, Komisioni konstatoi se subjekti dhe prindërit e tij, kane pasur mundësi me të ardhura të justifikuara për të paguar 700.000 lekë në vitin 2004.

⁴¹Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 18.10.2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 12.10.2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë; shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 3.11.2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec në dosjen e Komisionit.

⁴²Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 3.3.2021, nga DPSHTRR-ja në dosjen e Komisionit.

⁴³Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 18.10.2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 12.10.2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë; shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 3.11.2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, në dosjen e Komisionit.

⁴⁴Shihni dokumentet bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2 në dosjen e Komisionit.

63. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 1, subjekti ka deklaruar disa banesa në përdorim ose të marra me qira gjatë kohës që ka ushtruar funksionin e prokurorit në qytete të ndryshme. Komisioni kreu verifikime të deklarimeve të subjektit për pasuri: (i) banesë në pronësi të prindërve të tij në E***, marrë në përdorim; (ii) apartament në bashkëpronësi të shtetasve S. B. dhe L. B. në Pogradec, marrë me qira; (iii) apartament në pronësi të shtetasit M. H. në Korçë, marrë me qira; (iv) apartament në pronësi të shtetasës S. B. në Vlore, marrë me qira nga ku nuk rezultuan problematika. Nuk u evidentuan raste të konfliktit të interesit me këta shtetas⁴⁵.

64. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti ka deklaruar, midis të tjerash, se në periudhën shkurt - mars 2014 ka jetuar me qira së bashku me familjen në SHBA. Pasi u pyet për arsyet e vajtjes dhe për shpenzimet e lindjes së vajzës K. në SHBA, në përgjigje të pyetësorit nr. 4, subjekti ka deklaruar se ai dhe bashkëshortja, në vitin 2010, janë bërë përmes programit lotaria amerikane rezidentë të përhershëm në SHBA. Më tej ka sqaruar se në vitin 2014, duke qenë me këtë status, kanë vendosur që lindja e vajzës së tyre të bëhej në këtë shtet, për shkak të një trajtimi më të specializuar, por edhe marrjen e shtetësisë prej saj që nga lindja. Ai deklaroi se për lindjen e vajzës nuk kanë kryer shpenzime, pasi bashkëshortja e tij ka qenë me siguracion shëndeti nga shteti C., SHBA. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjekti i është kërkuar të provojë me dokumente shkresore që nuk ka kryer shpenzime për lindjen e vajzës në SHBA, duke paraqitur siguracionin e shëndetit etj.

64.1 Në parashtrimet e tij subjekti depozitoi një pasqyrë të detajuar të shërbimeve shëndetësore të marra prej bashkëshortes gjatë periudhës 27.1.2014 – 27.3.2014, nga *Community Health Services*. Në shpjegimet e tij në parashtrime, ashtu si edhe në seancë dëgjimore, subjekti deklaroi se nëpërmjet këtij dokumenti është njohur për herë të parë me shpenzimet e lindjes së vajzës, duke vijuar të këmbëngulte se pagesa e kryer nga ana e tyre ka qenë 0 (zero) dollarë, pasi nga këto shërbime një pjesë janë mbuluar nga siguracioni dhe një pjesë është dakordësuar nga spitali të mos tarifohen, sepse kompanitë e sigurimeve paguajnë tarifën spitalore të zbritura, specifike për secilën kompani sigurimi shëndeti. Sipas tij, bashkëshortja ka qenë e siguruar në periudhën e lindjes së vajzës me siguracion shëndeti (*insurance HUSKY A*) nga shteti C., SHBA. Përveç kopjes së dokumentit “*statement*” të datës 18.11.2022, subjekti ka paraqitur edhe kopje të numrit të punës “*Social Security*” të bashkëshortes së tij dhe kopjen e kartës “*Permanent Resident Card*” i bashkëshortes në SHBA në periudhën e lindjes së vajzës.

64.2 Për një vlerësim sa më objektiv në lidhje me shpenzimet për lindjen e vajzës në SHBA, në procesin e vlerësimit përfundimtar, Komisioni iu referua fakteve e rrethanave si vijojnë:

- Bashkëshortja N. M. nga viti 2010 është rezidente e përhershme në SHBA, përfutur përmes programit të lotarisë amerikane dhe është pajisur nga shteti amerikan me dokumentet “*Permanent Resident Card*” dhe “*Social Security*”.

- Në datën 22.2.2014 ka lindur vajza K., për të cilin subjekti ka deklaruar se nuk ka kryer shpenzime për shkak se ato janë mbuluar nga shteti amerikan, konkretisht nga siguracioni HUSKY A.

- Në dokumentin e titulluar *statement*, i cili i është dërguar bashkëshortes së subjektit me *email*-in e datës 18.11.2022 nga znj. M. J., punonjëse e *Community Health Services*, vërehet se shërbimet shëndetësore të marra prej bashkëshortes gjatë periudhës 27.1.2014 – 27.3.2014 dhe çmimet e tyre janë të paguara nga siguracioni i bashkëshortes.

⁴⁵Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 18.10.2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 12.10.2022, nga prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë; shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 3.11.2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, në dosjen e Komisionit.

- Nga kërkimi në *Google* rezulton se HUSKY⁴⁶ është sigurimi shëndetësor që ndihmon njerëzit me të ardhura të ulëta të paguajnë disa ose të gjitha faturat e tyre mjekësore. Ai njihet ndryshe si *Medicaid* ose “ndihma mjekësore”. Siguracioni HUSKY mund të jetë falas, ndër të tjera edhe për gratë shtatzëna me të ardhura më pak se 6.082 USD në muaj për një familje me 4 anëtarë (HUSKY A). Ky mbulim vazhdon për 12 muaj pas lindjes dhe përfshin edhe qytetarët të kualifikuar si jo shtetas. Qytetarë të kualifikuar si jo shtetas janë të gjithë personat që kanë një kartë rezidenti të përhershëm në SHBA.

64.3 Bazuar në të gjitha sa më sipër, në përfundim Komisioni vlerësoi bindëse pretendimet e subjektit në lidhje me mungesën e shpenzimeve për lindjen e vajzës në SHBA, pasi janë të bazuara në provat që ai paraqiti, si dhe në të dhënat e bëra të ditura publikisht. Megjithatë, Komisioni verifikoi mundësitë financiare të bashkëshortëve, në rastin kur shpenzimet në vlerën 5.577 USD konsiderohen si shpenzime të tyre. Nga analiza financiare e rishikuar për vitin 2014, rezulton një balancë negative prej 669.746 lekësh, e cila nuk mund të konsiderohet penalizuese për subjektin. Për më tepër që kjo është e vetmja balancë negative e analizës financiare të rishikuar gjatë procesit të vlerësimit përfundimtar të çështjes, për gjithë periudhën e rivlerësimit.

65. Në lidhje me shpenzimet e udhëtimit nga banesa në vendin e punës, meqenëse subjekti ka punuar në qytete të ndryshme nga vendbanimin i tij, u pyet për shpenzimet e zhvendosjes dhe/ose të qirasë, nëse është rasti. Në përgjigje të pyetësorit nr. 4, ka informuar mbi shpenzimet e qirasë dhe të udhëtimit për pjesë të caktuara të periudhave gjatë viteve që ai ka qenë në detyrë. Subjekti deklaroi se ai ka përdorur transportin publik, duke specifikuar sa ditë në vit ka udhëtuar dhe biletën e paguar. Këto shpenzime janë përlllogaritur nga Komisioni në bazë të këtyre deklarimeve të subjektit, të cilat kanë qenë bindëse.

Analiza financiare

66. Në përfundim të hetimit administrativ, për të evidentuar mundësinë e subjektit dhe familjes së tij për të krijuar pasuritë dhe likuiditetet gjatë periudhës së detyrës si prokuror, Komisioni kreu analizën financiare të pasqyruar në tabelën më poshtë. Sipas kësaj analize, ka rezultuar se pamundësia totale e subjektit (totali i viteve me balancë negative) për të krijuar pasuritë dhe për të kryer të gjitha shpenzimet e evidentuara është -126.788 lekë. Sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i ka kaluar barra e provës për të vërtetuar të kundërtën e këtij konstatimi.

	<i>Periudha 4.6.2012 - 31.12.2012</i>	2013	2014	2015	2016
PASURI	1 256 376	-23 191	39 456	298 190	304 125
Apartament me sip. 88.6 m ² , ***, blerë në vitin 2007					
Automjet tip “Mercedes-Benz”, me targa ***, blerë më 12.1.2015				1 376 500	-1 376 500
Automjet tip “Mercedes-Benz”, me targa ***			-140 110		
<i>Shtesa/pakësime likuiditeteve</i>	<i>1 256 376</i>	<i>-23 191</i>	<i>179 566</i>	<i>-1 078 310</i>	<i>1 680 625</i>
Gjendja e likuiditeteve	1 256 376	1 233 185	1 412 751	334 441	2 015 066
Të ardhura dokumentuar	1 749 533	1 575 062	1 553 754	2 184 206	2 424 178
Të ardhura nga paga, subjekti	582 693	1 017 628	1 176 254	1 234 538	1 393 006
Të ardhura nga paga, bashkëshortja	424 899	557 434	377 500	944 668	760 632
Bonus i bebeve nga bashkia				5 000	
Të ardhura nga shitja e automjetit					270 540
Të ardhura të motrës, viti 2012	67 820				

⁴⁶ <https://ctlawhelp.org/en/husky-health-insurance-medicaid> ; <https://portal.ct.gov/HUSKY>

Likuiditete të mbartura nga viti i kaluar për motrën	3 264				
Mbartje e efektit të kursimeve para detyrës	670 857				
Shpenzime	549 110	984 471	1 577 780	1 647 872	2 127 405
Shpenzime jetese	325 612	423 072	843 326	897 104	940 368
Shpenzime udhëtimi <i>TIMS</i>		260 791	280 000	192 710	186 858
Shpenzime qiraje		47 000	48 000	18 000	100 000
Shpenzime qiraje në SHBA			170 460		
Shpenzime mobilimi, pyetësori standard	50 000			100 000	150 000
Shpenzime kopshti vajzës DV				40 000	100 000
Shlyer kredia në “Alpha Bank”	143 098	236 008	235 994	227 948	221 572
Shpenzime të tjera/të ndryshme				31 660	93 336
Shpenzime transporti	30 400	17 600		2 800	
Shpenzime për riparimin/mirëmbajtjen e automjetit				137 650	135 270
Dhuruar prindërve gjatë vitit 2016					200 000
Mundësia për kursime	-55 954	613 782	-63 482	238 144	-7 352

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit

67. Subjekti ka kundërshtuar balancën negative, e cila sipas tij nuk qëndron. Në analizë të parashtrimeve dhe dokumenteve që subjekti paraqiti, evidentohet se:

67.1 Subjekti ka kundërshtuar balancën negative të mbartur para vitit 2012, që është periudha para fillimit të detyrës. Ky pretendim është gjendur i bazuar (trajtuar hollësisht në paragrafin 53.5 të këtij vendimi).

67.2 Subjekti kundërshton përfshirjen në analizën financiare të pagesave të kësteve të kredisë të kryera nga prindërit në vitet 2014 - 2015, si të paguara prej tij. Nga verifikimi i dokumenteve bankare rezulton se një pjesë e pagesave të kredisë janë paguar nga prindërit e subjektit, konkretisht në vlerën 1.195 euro, dhe pa të drejtë ato janë përfshirë si shpenzim në analizën financiare të subjektit në përfundim të hetimit administrativ. Për këtë arsye, kjo shumë është hequr si shpenzim në analizën financiare të rishikuar.

67.3 Subjekti pretendon se ka pasaktësi në paraqitjen e të ardhurave të bashkëshortes nga punësimi pranë subjektit “****” sh.p.k. Konkretisht, subjekti ka pretenduar se të ardhurat në total për vitin 2016 nga punësimi pranë subjekteve “****” sh.p.k. dhe “****” sh.p.k., janë në shumën 901.152 lekë dhe jo 760.632 lekë, sa i kishte përlllogaritur Komisioni, duke vërtetuar këtë fakt me vërtetimet nr.*** dhe nr. **, datë 10.10.2016, të ISSH-së. Bazuar në të dhënat e këtyre akteve shkresore, rezultoi se pretendimi i subjektit është i bazuar dhe pasi janë saktësuar të ardhura nga punësimi i bashkëshortes pranë subjektit “****” sh.p.k., në analizën financiare të rishikuar, si e ardhur nga punësimi pranë subjekteve të sipërpërmendura, është përfshirë shuma 907.272 lekë (është konstatuar një gabim në përlllogaritje nga ana e subjektit). Po kështu, pavarësisht se nuk kishin efekt në balancat e vitit, u saktësuan edhe të ardhurat për vitet 2012 - 2015 nga shoqëria “****” sh.p.k.

67.4 Gjithashtu, në analizën financiare të rishikuar janë saktësuar shpenzimet jetike të subjektit të rivlerësimit për vitin 2014, duke zbritur shpenzimet jetike në Shqipëri për 2 muajt e qëndrimit në SHBA për 3 anëtarët e saj (shkurt - mars) dhe 1 muaj për vajzën e porsalindur (mars), ndërkohë që janë përlllogaritur shpenzimet jetike në SHBA sipas minimumit jetik për këtë periudhë në vlerën 3.590 USD. Nga kjo shumë është zbritur 1.500 USD të llogaritura në analizën e kryer në përfundim të hetimit administrativ për shpenzimet e qirasë dhe në analizën financiare të rishikuar është shtuar si shpenzim për vitin 2014 vlera 2.090 USD (3.590 USD – 1.500 USD).

68. Në përfundim, pas vlerësimit të fakteve si më sipër, analiza financiare e rishikuar për periudhën e ushtrimit të detyrës rezultoi me mungesë burimesh të ligjshme në shumën 35.925 lekë, balancë kjo e krijuar për vitin 2014 dhe e pakonsiderueshme në disfavor të subjektit.

Vlerësimi përfundimtar i kriterit të pasurisë

69. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave të kreut IV të ligjit nr. 84/2016, Komisioni krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit Elion Mustafaj ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, pasi përmbush kriteret e nenit 33 të këtij ligji, për shkak se: (i) ka kryer deklarime të sakta në përputhje me ligjin (germa “a” e pikës 5); (ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet gjatë gjithë periudhës së rivlerësimit (germa “b” e pikës 5); (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë (germa “c” e pikës 5); si dhe (iv) nuk është gjendur në kushtet e konfliktit të interesit në dukje (germa “d” e pikës 5).

KONTROLLI I FIGURËS

70. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin nr. *** prot., datë 27.10.2017, mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Elion E. Mustafaj, i deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 2.3.2021, të KDZH-së, nga ku rezultoi se: (i) formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara nga vetë ai në deklaratën për kontrollin e figurës; (iii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për implikimin e tij apo për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar. Në konkluzion të këtij raporti, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit Elion E. Mustafaj.

71. Në vijim të një hetimi të pavarur, Komisioni ka kërkuar përditësim informacioni për subjektin. Nga të dhënat konfidenciale të organeve ligjzbatuese nuk kanë rezultuar të dhëna të përditësuara për këtë subjekt. Në përfundim të procesit gjatë të cilit nuk ka pasur të dhëna nga cilido burim i ligjshëm në lidhje me figurën e subjektit të rivlerësimit, nuk u evidentuan fakte dhe rrethana që cenojnë figurën e tij apo kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Në këto kushte, Komisioni çmoi se subjekti i rivlerësimit Elion Mustafaj është i përshtatshëm për vijimin e ushtrimit të detyrës, për shkak se ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

72. Në zbatim të neneve 40-44 të ligjit nr. 84/2016 është bërë rivlerësimi profesional i subjektit të rivlerësimit Elion Mustafaj, bazuar në: (i) raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit të kryer nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, me nr. *** prot., datë 10.11.2022, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 12.12.2022; (ii) informacionin e marrë nga burime të ligjshme; (iii) kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Konstatimet në raportin e KLP-së për aftësitë profesionale të subjektit

73. Raporti për analizimin e aftësive profesionale i kryer nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë është bazuar në: formularin e vetëdeklarimit, përvojën profesionale; detyrat e kryera për periudhën 8

tetor 2013 – 8 tetor 2016; trajnimet në 3 vitet e fundit; tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; pesë dosjet penale, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; të dhënat nga 23 prokuroritë pranë gjykatës së shkallës së parë dhe Prokurorisë së Përgjithshme.

74. Pasi ka analizuar të dhënat si më sipër, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në kriteret ligjore të parashikuara nga nenet 73-76 të ligjit nr. 96/2016, ka vlerësuar subjektin e rivlerësimit Elion Mustafaj, si vijon:

74.1 Aftësitë profesionale

Njohuritë ligjore

Subjekti ka shfaqur aftësi në interpretimin e ligjit, analizën e jurisprudencës dhe arsyetimit ligjor e logjik, duke marrë vendime dhe përpiluar akte të qarta e të plota.

Arsyetimi ligjor

Subjekti shfaq aftësi në pasqyrimin e rrethanave të faktit, analizën e provave në përputhje me bazën ligjore të aplikueshme. Aktet e përpiluara prej tij paraqiten të qarta dhe të kuptueshme. Respektohen rregullat e drejtshkrimit dhe niveli i arsyetimit është në përputhje me standardin e procesit të rregullt ligjor.

74.2 Aftësitë organizative

Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti Elion Mustafaj ka treguar aftësi në organizimin efektiv të kohës së punës, duke kryer detyrat e ngarkuara me efikasitet.

Aftësia për të kryer procedurat hetimore

Subjekti i rivlerësimit, në rastin e vendimmarrjes mbi mosfillimin e procedimit penal, rezulton të ketë argumentuar mungesën e elementeve të veprës penale. Në procedimet penale, për të cilat është vendosur pushimi i hetimeve, është realizuar drejtimi i hetimeve të kryera nga policia gjyqësore, duke argumentuar vendimmarrjen për pushimin e procedimit penal. Subjekti i rivlerësimit ka shfaqur aftësitë e nevojshme edhe mbi kontrollin e hetimeve të kryera nga policia gjyqësore për të mbështetur akuzën në çështjet me të pandehur të dërguar për gjykim.

Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i akteve të dorëzuara nga subjekti dhe dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, prokurori Elion Mustafaj, në ushtrim të kompetencave të tij, ka aftësi për të administruar dosjet.

74.3 Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

Etika në punë

Nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, prokuror Elion Mustafaj, për vitet 2014, 2015 dhe 2016, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se është vlerësuar “shumë mirë”, mbështetur në treguesit vjetorë të punës.

Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, prokuror Elion Mustafaj, dhe nga pesë dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

Paanësia

Nga dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Elion Mustafaj dhe nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar. Në asnjë prej dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave dhe nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

74.4 Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

Aftësitë e komunikimit

Nuk rezultojnë të dhëna që flasin për mënyrën e komunikimit ndërpersonal të subjektit me pjesëmarrësit në proces.

Aftësia për të bashkëpunuar

Nuk rezultojnë të dhëna konkrete që flasin mbi aftësinë e subjektit për të bashkëpunuar mes kolegësh apo më gjerë.

Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti ka marrë pjesë në një sërë trajnimesh me temë në fushën penale, të organizuar pranë dhe jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës.

Informacion i marrë nga burime të ligjshme

75. Nga të dhënat e burimeve arkivore ka rezultuar se: (i) ndaj subjektit të rivlerësimit, prokurorit Elion Mustafaj, nuk janë marrë masa disiplinore gjatë ushtrimit të detyrës; (ii) ndaj subjektit ka pasur disa kallëzime penale që i përkasin viteve 2016, 2017 dhe 2020, të cilat pasi janë trajtuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, është vendosur mosfillimi apo pushimi i procedimit penal, konkretisht: kallëzimi penal nr. *** mosfilluar; kallëzimi penal nr. *** mosfilluar; procedimi penal nr. *** i pushuar dhe paraqitur kërkesa për pushim para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, e cila e ka pranuar me vendimin nr. ***, datë 24.9.2020. Procedimi penal nr. *** është trajtuar në kuadër të procedimit penal nr. ***; (iii) subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “shumë mirë” për vitet kalendarike 2014, 2015 dhe 2016 nga Prokurori i Përgjithshëm.

76. Gjatë procesit të rivlerësimit subjektit iu kërkua të japë sqarime nëse ndaj vendimeve të mësipërme të mosfillimit dhe pushimit ka pasur ankime, si dhe të paraqesë vendimmarrjen përkatëse të gjykatës. Nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit⁴⁷ rezultoi se:

- Kallëzimi penal nr. ***, datë 25.10.2016, është mosfilluar në datën 23.12.2017 dhe nuk është ankimuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier.

- Kallëzimi penal nr. ***, datë 3.9.2020, është mosfilluar në datën 17.9.2020 dhe nuk është ankimuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier.

- Procedimi penal nr. ***, datë 18.9.2017, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier është kaluar në datën 30.7.2018 për kompetencë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Në vitin 2020 Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë e ka kthyer përsëri për kompetencë këtë procedim penal në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier ka regjistruar përsëri për këtë fakt procedim penal nr. *** (***) , datë 5.2.2020 dhe në datën 7.2.2020 ka dërguar kërkesën për pushimin e procedimit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier. Me vendimin nr. *** (***) , datë 24.9.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, është vendosur pranimi i kërkesës së Prokurorisë pranë Gjykatës

⁴⁷Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 2.12.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 5 në dosjen e Komisionit.

së Rrethit Gjyqësor Fier dhe pushimi i procedimit penal nr. ***, viti 2020. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. ***, datë 26.1.2021, të Gjykatës së Apelit Vlorë.

77. Në adresë të subjektit jenë dërguar pesë denoncime nga publiku, në dy prej të cilëve⁴⁸ ngriheshin pretendime që mund të zgjidhen nëpërmjet ushtrimit të së drejtës së ankimit ndaj vendimmarrjes përkatëse në gjykatë. Ndërsa për tre të tjera u kryen verifikime të mëtejshme, si vijojnë:

78. Dy denoncime nga shtetasi A. H.⁴⁹

78.1 Në denoncimin e tij të parë, të datës 18.2.2022, denoncuesi ngrinte pretendime mbi përgjigje të vonuar dhe jo të plotë nga ana e Prokurorisë së Rrethit Lushnjë. Gjatë hetimit administrativ, subjektit iu kërkua të japë sqarime mbi përgjigjen drejtuar denoncuesit dhe mbi pretendimet e tij. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti deklaroi se sikurse është informuar nga prokurorja e çështjes, ka pasur një lapsus në formulimin prej saj të kthimit të përgjigjes, dhe se, denoncuesit i është kthyer përgjigje për sa ka kërkuar, pasi informacioni i dhënë i referohej dy procedimeve penale që kërkoheshin. Sa i takon kthimit me vonesë të përgjigjes pas rreth 1 muaj e 8 ditë nga paraqitja e kërkesës, subjekti deklaroi se në vlerësimin e tij kjo nuk ka qenë përgjegjësi e Drejtuesit të Prokurorisë, por e prokurorit që ka pasur për ndjekje këto çështje penale. Për të mbështetur pretendimet e tij subjekti ka paraqitur disa dokumente shkresore⁵⁰.

Në përfundim të hetimit administrativ, në analize të deklarimeve dhe dokumentave shkresore të paraqitura, Komisioni vëren se subjekti ka ushtruar detyrat e tij si drejtues prokurorie në kthimin e përgjigjes denoncuesit, pa u evidentuar ndonjë mangësi. Nga ana tjetër, informacioni mbi ecurinë e çështjes penale konkrete është hartuar nga prokurorja e çështjes, e cila në zbatim të nenit 25 pika 2 e K.Pr.P dhe nenit 6 pika 1 të ligjit nr. 97/2016, është e pavarur në ushtrimin e funksioneve të saj, dhe si e tillë, është përgjegjësi e saj përmbajtja e informacionit dhe kthimi i përgjigjes brenda afatit.

78.2 Në denoncimin e dytë, të datës 24.2.2022, denoncuesi ngrinte pretendime se prokurori Elion Mustafaj kishte kërkuar pushimin e çështjes nr. ***, pa u kryer një hetim i plotë, dhe se ai nuk është thirrur asnjëherë për t'u pyetur në lidhje me këtë. Subjektit iu kërkua të japë sqarime mbi pretendimet e denoncuesit, veprimet hetimore të kryera prej tij në kuadër të këtij procedimi, si dhe mungesën e pyetjes së kallëzuesit, duke paraqitur dokumente nga dosja penale.

Në përgjigjet e pyetësorit nr. 3 subjekti ka informuar se procedimi penal nr. ***, datë 22.6.2021, i nisur nga një prokuror tjetër, i ishte caktuar atij për ndjekje të mëtejshme, pasi ishte caktuar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Lushnjë në datën 16.9.2021. Subjekti ka përshkruar në mënyrë të detajuar veprimet e kryera prej tij në kuadër të trajtimit të këtij procedimi. Ndërsa, sa i takon pyetjes së denoncuesit, ka sqaruar se pyetja e shtetasve të ndryshëm në cilësinë e personit që ka dijeni mbi ngjarjen është një veprim procedural jo i detyrueshëm për prokurorin, por varet nga natyra e çështjes dhe të dhënat që prokurori mund të sigurojë nga deklarimi. Në rastin konkret, mungesa e nevojës për kryerjen e një veprimi të tillë diktohej edhe nga fakti që ky shtetas ishte në cilësinë e kallëzuesit dhe pretendimet e tij ishin materializuar në aktin e kallëzimit. Në mbyllje të sqarimeve të tij subjekti ka informuar se kjo mënyrë e interpretimit të provave dhe të ligjit është verifikuar edhe në rrugë gjyqësore dhe kërkesa e tij për pushimin e çështjes penale është miratuar më pas me vendimin nr. *** (***) , datë 5.5.2022, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

⁴⁸Shihni denoncimin nga shtetasi L. M., protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 15.5.2018; denoncimin nga shtetasi M. I., protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 24.5.2018, në dosjen e Komisionit.

⁴⁹Shihni denoncimet protokolluar me nr. *** prot., datë 18.2.2022 dhe nr. *** prot., datë 24.2.2022, në dosjen e Komisionit

⁵⁰ Shihni dokumentat: (i) letra e shtetasit A. H., regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë me nr. ***, dt.23.12.2021, me shënimet e Drejtuesit të Prokurorisë; (ii) shkresa nr. *** prot, dt.01.02.2022, e nënshkruar nga prokurore znj. M. S., drejtuar shtetasit A. H., me lëndë "kthim përgjigje letrës tuaj të datës 22.12.2021; (iii) vërtetim datë 07.11.2022, i sekretares së zyrës së regjistrimit dhe kryesekretares së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë; (iii) informacion datë 07.11.2022, i Zyrës së Protokollit, kryesekretares së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë.

Subjekti i ka shoqëruar pretendimet e tij me dokumente shkresore nga dosja e procedimit penal nr. ***.

Në përfundim të hetimit administrativ, bazuar në deklaratimet dhe provat e paraqitura nga subjekti, Komisioni analizoi të gjitha veprimet hetimore të ndjekura nga subjekti të cilat janë paraqitur hollësisht në rezultatet e hetimit administrativ, dhe konstatoi se ai ka vepruar në ushtrim të funksioneve të tij në mënyrë të pavaruar, sipas nenit 3/2 të ligjit 96/2016, duke mos evidentuar mangësi profesionale të tij.

79. Në dy denoncime të paraqitura nga shtetasja V. T.⁵¹ ngriheshin pretendime se subjekti, asokohe OPGJ, në bashkëpunim edhe me OPGJ-në U. B. dhe prokuroren e çështjes, kanë pasqyruar qëllimisht në mënyrë të pavërtetë faktet në procesverbale. Nga përmbajtja e denoncimit konstatohet se pretendimet e denoncueses kanë të bëjnë me pasqyrimin e pavërtetë të fakteve në procesverbalin e pyetjes së një shtetasi nga subjekti si OPGJ, pretendime për të cilat vlerësohet se mund të zgjidhen vetëm nëpërmjet ankimit në organin e akuzës. Gjatë hetimit administrativ, SPAK⁵² ka informuar se ndaj shtetasit Elion Mustafaj është regjistruar kallëzimi penal nr. *** i vitit 2021, i denoncueses V. T., për të cilin pas verifikimit është vendosur mosfillim procedimi në datën 6.7.2021, duke vënë në dispozicion të Komisionit fashikullin e mosfillimit të këtij procedimi. Me kërkesë të Komisionit, në parashtrimet e tij subjekti ka informuar se ndaj vendimit të mosfillimit nuk është ushtruar ankim, duke paraqitur shkresën nr. *** prot, datë 16.12.2022, të SPAK-ut, që konfirmon këtë fakt.

80. Në denoncimin e paraqitur nga shtetasi A. B.⁵³, informohet se në datën 1.9.2020 ky shtetas ka paraqitur pranë SPAK-ut një kallëzim penal për subjektin e rivlerësimit Elion Mustafaj për disa vepra penale dhe në vijim është informuar se ky kallëzim i është përcjellë për kompetencë Prokurorisë së Rrethit Fier. Denoncuesi informon Komisionin se nuk ka asnjë informacion se çfarë është bërë me këtë kallëzim. Nisur nga ky informacion, Komisioni kërkoi të dhëna nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Fier, e cila informoi se⁵⁴ me vendimin e datës 17.9.2020 është vendosur mosfillimi i procedimit penal lidhur me këtë kallëzim, duke e vënë në dispozicion të Komisionit këtë vendim. Me kërkesë të Komisionit, në parashtrimet e tij, subjekti ka informuar se ndaj vendimit të mosfillimit nuk është ushtruar ankim, vërtetuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier me shkresën nr. *** prot., datë 2.12.2022.

81. Rivlerësimi profesional sipas kriterëve të parashikuara në nenin 71 dhe vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Në zbatim të pikës 1 të nenit 42 dhe të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit 77 të ligjit nr. 96/2016, është kryer vlerësimi përfundimtar lidhur me secilin prej kriterëve të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit, sipas kriterëve të parashikuara në kreun II të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe pikën 2 të nenit E të Aneksit të Kushtetutës, duke u vlerësuar se:

- i) Subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të mira profesionale, sipas nenit 73 të ligjit nr.96/2016.
- ii) Subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të mira organizative, sipas nenit 74 të ligjit nr. 96/2016.
- iii) Subjekti i rivlerësimit ka treguar etikë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale, sipas nenit 75 të ligjit nr. 96/2016.

⁵¹Shihni denoncimet nga shtetasja V. T., protokolluar me nr. *** prot., datë 12.5.2021 dhe nr. *** prot., datë 4.5.2022, në dosjen e Komisionit.

⁵²Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 11.11.2021, nga SPAK, në dosjen e Komisionit.

⁵³Shihni denoncimin nga shtetasi A. B., protokolluar me nr. *** prot., datë 10.6.2021, në dosjen e Komisionit.

⁵⁴Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 4.11.2022, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, në dosjen e Komisionit.

iv) Subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi personale dhe angazhim profesional, sipas nenit 76 të ligjit nr. 96/2016.

Për sa më sipër, sipas germës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, me propozim të relatores së çështjes, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “i aftë” profesionalisht, për shkak se ka arritur nivelin kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale.

IV. SEANCA DËGJIMORE

82. Seanca dëgjimore e datës 22.12.2022 me subjektin e rivlerësimit Elion Mustafaj u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016 në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z.Theo Jacobs. Gjatë seancës, subjekti i rivlerësimit shprehu qëndrimin e tij lidhur me rezultatet e hetimit administrativ, si dhe me procesin e rivlerësimit dhe depozitoi akte shkresore të cilat u administruan nga sekretaria gjyqësore. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë. Në seancën e datës 23.12.2022, sipas pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, u shpall vendimi.

V. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

83. Me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, si dhe krijimin e bindjes së brendshme, gjatë hetimit administrativ trupit gjykues ka komunikuar me anë të postës elektronike me subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 46 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë gjatë seancës dëgjimore. Gatishmëria dhe qëndrimi bashkëpunues i subjektit gjatë gjithë procesit të rivlerësimit janë mbajtur në konsideratë gjatë procesit të vendimmarrjes, sipas parashikimit të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016.

VI. KONKLuzion PËRFUNDIMTAR

84. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni krijoi bindjen se:

- Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas nenit 59/a të ligjit.
- Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm për kontrollin e figurës, sipas nenit 59/b të ligjit.
- Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas nenit 59/c të ligjit.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, sipas parashikimit të pikës 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, me propozim të relatores së çështjes, e cila kërkoi konfirmimin në detyrë, bazuar në germën “a” të pikës 1 të nenit 58 dhe pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Elion Mustafaj, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, aktualisht në funksionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe

publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë në datën 23.12.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Valbona SANXHAKTARI
Kryesuese

Firdes SHULI
Relatore

Olsi KOMICI
Anëtar

Sekretare gjyqësore
Ertugena Sokoli